

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit
Program i Integruar Master i Shkencave në Drejtësi (PIND)
ofruar nga Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Evis Alimehmeti

Dr. Darinka Piqani



Maj 2019



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Program i Integruar Master i Shkencave në Drejtësi (PIND)

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron:	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit:	VKM Nr. 939, datë 03.09.2009 Shkresë Nr. 6858/2 Prot., datë 06.05.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë:	UMASh Nr. 341 datë 28.08.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Program i integruar studimi Master i Shkencave në "Drejtësi"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
16	Numri i studentëve:	67 studentë (Sipas të dhënave të marra në sekretarinë mësimore)

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Program i Integruar Master i Shkencave në "Drejtësi" (PIND)

Mbështetur në VKM Nr. 939, datë 03.09.2009, Shkolla e lartë universitare private "University of New York, Tirana" ka hapur programin e studimit Program i Integruar Master i Shkencave në Drejtësi. Ky program është hapur si program i integruar i studimit i ciklit të dytë, me kohë të plotë. Kohëzgjatja e programit është 5 vite me një numër total të 300 krediteve. Në përfundim të këtij programi lëshohet "Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë"(DIND) në Drejtësi. Me Urdhër Nr. 203, datë 06.05.2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka dhënë lejen për ushtrimin e aktivitetit akademik për këtë program si program i integruar i ciklit të dytë në "Drejtësi".

Këshilli i Akreditimit, me vendimin Nr. 507, datë 18.07.2013, dha vlerësimin pozitiv për programin në fjalë si dhe publikoi disa rekomandime për t'u plotësuar nga institucioni për përmirësimin e cilësisë së këtij programi. Konkretisht këto rekomandime janë:

1. Të rritet kërkimi shkencor në nivel institucional;
2. Të përmirësohet regjistri i amzës, i cili duhet të jetë me shkrim dore dhe gjithashtu notat duhet të mbahen edhe nëregjistrë me shkrim dore.

Mbështetur në Vendimin Nr. 507 të Këshillit të Akreditimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Urdhrin Nr. 341, datë 19.08.2013 ka akredituar programin e studimit në fjalë si dhe ka urdhëruar Shkollën e Lartë Universitare të plotësojë rekomandimet e Këshillit të Akreditimit. Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 184, datë 16.05.2013, është bërë regjistrimi i formës së diplomës së këtij programi si Master i Shkencave në "Drejtësi".

Shënim lidhur me përmbajtjen e këtij raporti vlerësimi:

Në tetor 2018, i njëjti GVJ i përbërë nga Prof. Alimehmeti dhe Dr. Piqani, u angazhua pranë të njëjtit institucion lidhur me vlerësimin e programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare". Pas vizitës në institucion, GVJ, në dhjetor 2018, doli me një raport të vlerësimit të jashtëm. Në shkurt 2019, gjatë dhe pas vizitës në institucion në kuadër të vlerësimit të programit të studimit Program i Integruar Master i Shkencave në "Drejtësi", GVJ vuri re se Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për këtë program, hartuar nga Institucioni, përmbante pjesë të tëra të marra nga Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i dhjetorit 2018, i hartuar nga GVJ lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare".



Në këtë raport vlerësimi, GVJ është mbështetur në disa formulime të përdorura në raportin e vlerësimit të Dhjetorit 2018 për programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ):

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Evis Alimehmeti dhe Dr. Darinka Piqani si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga specialistja e ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Më datë 10.04.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 35/40, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, i hartuar nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit.

Përmes sistemit AMS, më datë 12.04.2019, si dhe me shkresë zyrtare Nr. 137/2019 Prot., datë 15.04.2019, me lëndë "Përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e Integruar Master i Shkencave në Drejtësi (PIND), në kuadër të akreditimit periodik", Institucioni përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.



GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

1. **Komenti 1 i IAL:** Në lidhje me konstatimin e dhënë nga grupi i eksperteve të vlerësimit të jashtëm (GVJ) se përmbajtja e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programin në Drejtësi përmbante pjesë të tëra të marra nga RVJ i Dhjetor 2018 i hartuar nga GVJ lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare", institucioni jonë nuk dakordësohet me këtë konstatim duke pasur parasysh faktin se pjesët që kanë ngjashmëri në të dyja raportet janë pjesë të cilat lidhen ngushtë me institucionin tonë. RVJ e Dhjetor 2018, bazohet në formulimet që GVB ka pasqyruar për këtë program studimi "Master i Shkencave" në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare" në RVB përkatëse në shtator 2018. Konstatojmë se, materialet që janë marrë pjesë nga RVJ Dhjetor 2018 janë pranuar si fakte nga UNYT të cilat kanë lidhje vetëm me pjesën institucionale dhe ne si IAL duke pranuar vlerësimin e bërë e konsideron atë të drejtë dhe të mbështetur duke e bërë pjesë të funksionimit dhe qasjes së raportit RVB në janar të vitit 2019. Për këtë arsye, UNYT kërkon që paragrafi i parë të riformulohet duke u hequr vetëm pjesa e fjalisë së mëposhtme: "...të tëra të marra...".

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të parë nga institucioni, GVJ sqaron se ngjashmëritë e konstatuara përfshijnë jo vetëm *fakte* që lidhen me institucionin (si p.sh lista e publikimeve të stafit akademik) por dhe *formulime* si p.sh pjesë të konsiderueshme nga analiza SWOT e programit të studimit "Master i Shkencave në "E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare" që është inkorporuar më pas në RVB për programin e studimit në fjalë. Pra marrja e tekstit *copy paste* duke e paraqitur si punë të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm është lehtësisht e evidentueshme nëse krahasohen 2 raportet. Sa më sipër, GVJ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë formulimin e shënimit lidhur me ngjashmëritë e konstatuara në raportet përkatëse.

2. **Komenti 2 i IAL:** Lidhur me Konkluzionet e Vlerësimit të Seksionit 1 pika 3 lidhur me konstatimin që GVJ bën për dedikimin e 60 krediteve të programit jo në lëndë të fushës së Drejtësisë duke i quajtur të papërshtatshme dhe konsideruar që nuk i qëndrojnë klasifikimit të lëndëve në kategori sipas akteve nënligjore, dëshirojmë t'iu risjellim në vëmendje edhe njëherë sikundër janë pasqyruar dhe në RVB që këtë kategori lëndësh i kemi në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi. (Tabela)
Në vijim lidhur me konstatimin për mungesën e lëndëve klasike të programeve të drejtësisë e kundërshtojmë fort pasi në programin që UNYT ofron ndër vite është ofruar lënda Prisons & Penalties e cila korenspondon me programin e lëndëve Krimnologji dhe Penologji.

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të dytë, GVJ sqaron se dhe mbi bazën e udhëzimit përkatës të Ministrisë, lëndë bazë në fushën e drejtësisë janë lëndë të formimit bazë në fushën e studimit. Sa më sipër, GVJ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë konstatimet e bëra në raport lidhur me këtë çështje.

3. **Komenti 3 i IAL:** UNYT konstaton se komenti i GVJ lidhur me Standardin III.8 në lidhje me ngarkesën mësimore nuk qëndron bazuar në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 2.1/d e cila nuk parashikon një minimum të orëve të ngarkesës mësimore javore por një maksimum deri në 25 orë. Dëshirojmë të risjellim në vëmendje se UNYT ka themeluar këtë program në partneritet me Universitetin e Greenwich duke ofruar një diplomë të dyfishtë çka sjell se dhe organizimi i këtij programi është bërë në përputhje me kërkesat e Universitetit partner. Mësimdhënia në UNYT ofrohet në formën interaktive.

Lidhur me komentin që GVJ ka dhënë në paragrafin e fundit në faqën 30/31 të RVJ për mosdisponueshmërinë e literaturës akademike në Gjuhën Angleze për lëndët themelore të programit kundërshtojmë këtë konstatim. Kjo pasi përmbushja e objektivave akademike në UNYT nuk bazohet nëpërmjet përmbledhjeve të informacioneve të sistemeve të tjera por në një shpërndarje të barabartë

ose kuasi të barabartë të literaturës së mirefilltë akademike në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Si psh. meqënëse GVJ ka marrë si shembull lëndën e të Drejtës Familjare për mungesë të literaturës në gjuhën angleze, po ju sjellim në vëmendje literaturën që pedagogët e kësaj lënde kanë parashikuar në Syllabus dhe që janë të aksesueshme në bibliotekën e universitetit ose mundësohen nga lektorët e lëndëve. Si për shembull literatura e vënë në dispozicion e aksesueshme nga studentët në të gjitha format e sipër cituara për të Drejtën Familjare meqënëse e morëm si rast është si më poshtë:
Kate Standley. (2010). Family Law, Palgrave.

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të tretë, GVJ sqaron se, siç është përmendur dhe në Draft-RVJ, në bazë të orarit të lëndëve dhe në komunikimet me studentët “rezulton një angazhim në auditor për 5 lëndë në javë në 3 orë sipas studentëve duke arritur në ngarkesën në numrin 15 orë/javë, që është më e ulët se kërkesat e udhëzimit Nr. 15, datë 4.4.2008 “Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”. Ky udhëzim parashikon në pikën II.4 se ngarkesa javore në auditor për leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorë është në intervalin e 20 - 25 orëve mësimore 60-minutash. Ky udhëzim ka vepruar për të gjitha vitet akademike në shqyrtim përveç vitit akademik 2018-2019. Udhëzimi të cilit i referohet institucioni në komentet e tij vepron vetëm për vitin aktual akademik 2018-2019 të vlerësimit dhe nuk rregullon vitet nga 2013-2018. Megjithatë, dhe parashikimi i udhëzimit të ri Nr. 41, datë 24.01.2018 për ngarkesën mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50 minutëshe, duhet të kuptohet në logjikën e një intervali të afërt me këtë kufi sidomos për programe të ciklit të dytë të studimeve. Ndërkohë, siç është përmendur dhe në raport, ngarkesa në javë në programin e studimit në fjalë është 15 orë.

Sa më sipër, GVJ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë gjetjet e bëra në raport lidhur me këtë pikë.

Në përgjigje të komentit lidhur me (mos) disponueshmërinë e teksteve mësimore në gjuhën angleze për lëndët themelore të programit, GVJ sqaron se kjo vështirësi krijohet si pasojë e natyrës së lëndëve themelore të programit të cilat fokusohen në sistemin e brendshëm të së drejtës dhe, nga ana tjetër, mospasja e literaturës akademike në gjuhën angleze në këto fusha themelore të së drejtës shqiptare. Literatura akademike mbi të drejtën shqiptare është në gjuhën shqipe dhe siç përmendet në Draft-RVJ “përmbushja e objektivave të lëndëve nuk mund të arrihet nëpërmjet një përmbledhjeje të informacioneve të sistemeve të tjera në gjuhë angleze. Për shembull, në lëndet Criminal Law I dhe Criminal Law II, literatura, me të drejtë, është tërësisht e bazuar në komantar në gjuhën shqipe si dhe vendime të gjyqësorit shqiptar”.

Për pasojë, GVJ nuk e sheh të arsyeshëm ndryshimin e formulimit lidhur me këtë çështje.

4. **Komenti 4 i IAL:** Lidhur me pretendimin se: “...lidhja e burimeve me qëllimet e kursit është e largët duke mundësuar konsultimin e një literature por jo zbrëthimin e objektit kryesor të fushës së studimit në sistemin vendas” nuk biem dakord për kurset e përmendura pasi natyra e atyre kurseve është një gërshetim i njohurive ndërkombëtare dhe atyre vendase, objektiv që pasqyrohet edhe në Syllabuset përkatëse.

Përsa i përket konstatimit të çështjes së “mbivendosjes e temave në lëndë të ndryshme e cila sjell përsëritje në njohuri që duhet evituar.” theksojmë se trajtimi i këtyre tematikave bëhet në kontekste të ndryshme. Për më tepër përsëritja e dijeve ndihmon në forcimin dijeve tek studentët.

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të katërt, GVJ vë re se mund të ketë një keqkuptim lidhur me observimin e bërë nga ana e eksperteve: qëllimi i literaturës duhet të jetë edukimi parësor mbi të drejtën shqiptare i cili nuk duket të mundësohet nga literatura anglisht që ka në përgjithësi programi.

Gjithashtu, në përgjigje të komentit lidhur me mbivendosjen e temave të caktuara në disa lëndë, GVJ vë re se konteksti në lëndët *Comparative Public and Constitutional Law, Foundations of Public Law, Constitutional Law and Legislative Process and Techniques* është i ngjashëm. Mbivendosja e temave si ndarja e pushteteve, natyra e kushtetutave, pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor në këto lëndë

mbart riskun e mospasjes së një vlere të shtuar ndërkohë që merr nga hapësira e lëndës që mund t'u kushtohet temave të tjera. Për këto arsye, GVJ nuk e sheh të arsyeshëm ndryshimin e formulimit lidhur me këtë çështje.

5. **Komenti 5 i IAL:** Përsa i përket literaturës që UNYT ka në dispozicion për studentët e tij, theksojmë se studentët trajnohen për mënyrën e aksesimit të rrjeteve online që UNYT është i abonuar ku duhet të përmendim bibliotekën online të Empire State College nga ku mund të aksesohen revistat prestigjioze si; Proquest, ebsco, gail, google scholar dhe ato të Universitetit të Greenwich. UNYT gjithashtu është abonuar në dy revistat prestigjioze Jstore dhe Emerald duke mos harruar dhe abonimin e McGraw Hill që nga viti 2017.

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të pestë, GVJ nuk i vë në dyshim përpjekjet e Institucionit për të vënë në dispozicion të studentëve *database* elektronike nëpërmjet të cilave ata mund të aksesojnë literaturën ndërkombëtare. Megjithatë konstatimet e GVJ lidhen me përditësimin e fondit të bibliotekës në institucion si dhe me sigurimin e titujve, sidomos në gjuhën shqipe, fizikisht në bibliotekë. Për këto arsye, GVJ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë formulimin e konstatimeve lidhur me bibliotekën.

6. **Komenti 6 i IAL:** Përsa i përket çështjes për angazhimin në mësimdhënie të stafit akademik ku GVJ konstaton se nuk është në përputhje të plotë me Nenin 59 pika 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë ne nuk biem dakord me këtë konstatim duke pasur parasysh faktin se program i ofruar në Drejtësi është Program i Integruar i cili përkon me Nivelin 7 të Kornizës së Kualifikimeve dhe bën pjesë në programin e General Qualification ku të dyja ciklet e studimit janë të integruar. Ne theksojmë se në shumicën e lëndëve të cilat i korrespondojnë nivelit Master përkatësisht vitit të 4-ët dhe 5-të lektorët e lëndëve mbajnë titullin Prof. Assoc ose PhD dhe stafi akademik me Master Shkencor është i angazhuar në asistencë në mësimdhënie.

Sqarimi i GVJ: Në përgjigje të komentit të gjashtë, GVJ vë re se përmbushja e kriterëve për gradat e titujt të personelit që angazhohet në mësimdhënie duket të jetë në vëmendjen e institucionit përderisa sidomos në vitin e fundit akademik ka një kombinim në mësimdhënie midis stafit me gradë shkencore dhe me master shkencor. Megjithatë, siç është theksuar dhe në raport, *ky angazhim i theksuar i personelit me grada e tituj në një numër shumë të lartë lëndësh për qëllime të arritjes së kriterit të gradës dhe titullit rrezikon të ndikojë negativisht në realizimin me cilësi të kësaj ngarkese, duke patur parasysh dhe kërkimin shkencor që duhet të shoqërojnë përgatitjen në lëndë.* Për këto arsye, GVJ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë formulimin e gjetjeve lidhur me angazhimin e stafit akademik në mësimdhënie.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a. Të rritet kërkimi shkencor në nivel institucional;
- b. Të përmirësohet regjistri i amzës, i cili duhet të jetë me shkrim dore dhe gjithashtu notat duhet të mbahen edhe në regjistër me shkrim dore.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a. Për rekomandimin "a", GVJ konstaton që Institucioni, që nga akreditimi i mëparshëm, është përfshirë në disa projekte kërkimore, organizime konferencash e aktivitete shkencore. Institucioni ka arritur të jetë pjesë e disa projekteve kërkimore shkencore si dhe gjithashtu ka mbështetur me fonde të brendshme aktivitetin shkencor. Një pjesë e stafit të angazhuar në programin e studimit në fjalë ka publikime në revista kombëtare ose ndërkombëtare, disa në revista prestigjioze, një pjesë tjetër në revista më pak të njohura dhe me një vizibilitet më të ulët. Mund të thuhet sidoqoftë që përpjekjet e bëra janë të vlerësueshme e për këtë arsye **GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet përgjithësisht i plotësuar por në nevojë për t'u zhvilluar e konsoliduar më tej.**
- b. Për rekomandimin "b", GVJ konstaton që regjistri i amzës mbahet me shkrim dore, ndërsa regjistri i notave me shkrim dore ende nuk përdoret nga Institucioni, pasi përdoret ai i digjitalizuar. Sa më lart, **GVJ konkludon se ky rekomandim konsiderohet i plotësuar pjesërisht.**



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Universiteti i New York-ut në Tiranë, është hapur me anë të vendimit Nr. 397, datë 15.08.2002 të Këshillit të Ministrave si Shkollë e lartë Universitare dhe është transformuar në Universitet me VKM Nr. 448, datë 11.07.2012. Programi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi është organizuar sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741 të 2007, sipas vendimit Nr. 939 të datës 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave dhe është akredituar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit e Shkencës Nr. 341 datë 28.08.2013, bazuar nëvendimin Nr. 341 datë 28.08.2013 të Këshillit të Akreditimit. Deri në vitin akademik 2014-2015 programi është ofruar në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich.

Programi ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (ish Fakulteti i Drejtësisë, Artit dhe Shkencave), Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane i cili ofron gjithashtu edhe 2 programe Master Shkencor në “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.

Në drejtim të objektivave të programit dhe lidhjes së tyre me misionin dhe objektivat strategjike të Institucionit të Arsimit të Lartë, referuar Statutit të Institucionit dhe dokumentave të tjerë të zhvillimit të tij mund të thuhet se objektivat e programit Master Shkencor janë në linjë me objektivat e vendosura nga Institucioni. Kështu, edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe ngritja e organizimi i studimeve të larta në të tre ciklet e studimit është në objektivat themelore të parashikuara në Statutin e Institucionit. Në këtë drejtim, përgatitja e profesionistëve në fushën e drejtësisë në njohuri të së drejtës shqiptare dhe njëkohësisht të asaj ndërkombëtare dhe evropiane synon përmbushjen e këtij objekti.

Në drejtim të rëndësisë së programeve në fushën e drejtësisë, ngritja e programeve të arsimit të lartë që ofrojnë njohuri të avancuara në drejtim sidomos të zhvillimeve në të drejtën në nivelin ndërkombëtar e në qasje të krahasueshëm me programe drejtësie në rajon e më gjerë mbetet e një rëndësie të lartë. Ofrimi i programeve në gjuhën angleze dhe mbi një kurrikul të mbështetur nga burime të huaja informacioni për disiplina të së drejtës ndërkombëtare, të drejtës së Bashkimit Evropiane dhe asaj të krahasuar është i nevojshëm, rrjedhimisht zhvillimi i programeve të tilla ka rëndësi sidomos në kuadër të rritjes së konkurrueshmërisë dhe nevojës për standarde të larta të programeve të arsimit të lartë.



- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
 - Memorandum of Agreement UNYT – Greenwich, 2010

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Misionet e Institucionit të artikuluara në dokumentat themelore të tij, përfshijnë ofrimin e programeve universitare dhe pas universitare që synojnë një përgatitje të përshtatshme të profesionistëve në lëmin e shkencës kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndër qëllimet dhe misionet kryesore të Institucionit në Planet Strategjike të Institucionit 2018-2022 dhe 2013-2017 dhe nenit 3 të Statutit të Institucionit, identifikohen zhvillimi i programeve në 3 nivelet e arsimit të lartë, që synojnë përgatitjen e profesionistëve të suksesshëm në një mjedis divers e ndërkombëtar, të pajisur me dije e

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>njohuri të avancuara, aftësi analitike, kërkimore, metodike dhe njëkohësisht me qasje ndaj vlerave të integritetit dhe etikës njerëzore e profesionale. Programi i integruar Master i Shkencave në "Drejtësi", sipas parashikimeve në "Rules of Regulation" të programit, synon ofrimin e një programi i cili duke kombinuar teorinë me praktikën në të drejtën vendase dhe atë ndërkombëtare do të mundësojë përgatitjen e profesionistëve të përshtatshëm për tregun në disa drejtime për shkak të orientimit të programit ndaj rregullimeve moderne dhe zhvillimit të aftësive analitike e kritike kombinuar me ato praktike. Përgatitja e profesionistëve të tillë në fushën e drejtësisë është e rëndësishme për qëllime të zhvillimit të shoqërisë sidomos në kuadër të proceseve aderuese të vendit. Sidoqoftë, në lidhje me kërkesat e tregut të punës, Institucioni ka vetëm një dokument bazik të quajtur policy paper, i cili edhe në përmbajtjen e tij konsiderohet vetëm si hapi i parë në përgatitjen e një raporti analize të tregut i cili duhet të ishte përmbushur tashmë, jo e formalizuar në sondazhe apo analiza formale të përgjigjes së tregut ndaj objektivave të programit.</p> <p>Në lidhje me objektivin e ruajtjes së vlerave kombëtare, mund të thuhet që në një vlerësim të objektivave të programit dhe komponentëve të tij, vlerat kulturore kombëtare janë të observuara sidomos në drejtim të përfshirjes së lëndëve që lidhen me zhvillime të shoqërisë shqiptare.</p>
<p>Standardi L2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Siç është përmbledhur edhe në pjesën përshkrimore të këtij seksioni, referuar Planeve Strategjike të Institucionit 2018-2022 dhe 2013-2017, mund të thuhet se objektivat e programit Master Shkencor janë në linjë me objektivat e vendosura nga Institucioni. Kështu, edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe ngritja e organizimi i studimeve të larta në të tre ciklet e studimit është në objektivat themelore të parashikuara në Statutin e Institucionit. Në këtë drejtim, përgatitja e profesionistëve në fushën e drejtësisë në njohuri të së drejtës shqiptare dhe njëkohësisht të asaj ndërkombëtare dhe evropiane synon përmbushjen e këtij objekti.</p> <p>Dokumenti themelor që lidhet me organizimin e programit të integruar në Drejtësi, "Rregullore e Programit", evidenton si objektiva kryesore të tij arritjen e 4 qëllimeve të cilat në tërësi përfaqësojnë përpjekje në linjë me Strategjinë e Institucionit për të kontribuar në përgatitjen e profesionistëve të aftë në fushën e drejtësisë, pajisur me aftësi dhe cilësi të përshtatshme për përthithjen nga tregu i punës.</p>
<p>Standardi L3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Nga ana formale programi i integruar në Drejtësi është në linjë me kërkesat në numrin e krediteve dhe shtrirjen në 5 vite. Në drejtim të përmbajtjes programi ka tipare që mund të influencojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë jo ezauruese. Kështu, viti i parë i studimit përfshin lëndë të cilat nuk lidhen me fushën e drejtësisë si algjebra, kompozimi dhe arti, etj. Ky vit i parë është i përbashkët për çdo degë studimi të ofruar nga ana e Institucionit, duke i mundësuar studentëve zgjedhjen e drejtimeve përkatëse në drejtësi, ekonomi etj., në vitin e dytë. Megjithë vlerën e pranueshme të ofrimit të disiplinave të tjera që zhvillojnë logjikën dhe hobe të studentëve, dedikimi i 60 krediteve nga 300 kredite të programit jo në lëndë të fushës së drejtësisë është i papërshtatshëm dhe nuk i qëndron as klasifikimit të lëndëve në kategori dhe përqindje sipas Udhëzimit Nr. 15, datë 04.04.2008 "Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" dhe Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Kjo duket edhe në mungesën në program të lëndëve klasike të programeve të drejtësisë si kriminalogji/penalogji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj.

Në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit, programi i integruar Master i Shkencave në Drejtësi lidhet me nivelin 7 të Kornizës.

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Institucioni ka hartuar Plane Strategjike 4 vjeçare 2018-2022 dhe 2012-2017; sidoqoftë të dy dokumentat dhe në përgjithësi dokumentat themelore të Institucionit nuk kanë veshje zyrtare, duke mos përcaktuar autoritetin miratues, datën e vendimit përkatës dhe siglën e institucionit.

Përtej kësaj problematike, mund të thuhet se në të dy Planet strategjike të Institucionit përfshihen objektiva në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, metodologjisë së mësimdhënies duke synuar ekselencën akademike, zhvillimin e kërkimit shkencor të personelit akademik, përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së personelit dhe matjen e qëndrueshme të saj, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ndër qëllimet dhe misionet kryesore të Institucionit në Planet Strategjike të Institucionit si dhe nenit 3 të Statutit identifikohen zhvillimi i programeve në 3 nivelet e arsimit të lartë, që synojnë përgatitjen e profesionistëve të suksesshëm në një mjedis divers e ndërkombëtar, të pajisur me dije e njohuri të avancuara, aftësi analitike, kërkimore, metodike dhe njëkohësisht me qasje ndaj vlerave të integritetit.
2. Në dy Planet Strategjike të Institucionit përfshihen objektiva në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, metodologjisë së mësimdhënies duke synuar ekselencën akademike, zhvillimin e kërkimit shkencor të personelit akademik, përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së personelit dhe matjen e qëndrueshme të saj.
3. Nga ana formale programi i integruar në Drejtësi është në linjë me parimet e organizimit në kredite e cikle sipas Kartës së Bolonjës dhe kuadrit ligjor në fuqi. Në drejtim të përmbajtjes programi ka tipare që mund të influencojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë jo ezauruese. Dedikimi i 60 krediteve nga 300 kredite të programit jo në lëndë të fushës së drejtësisë është i papërshtatshëm dhe nuk i qëndron as klasifikimit të lëndëve në kategori dhe përqindje sipas akteve nënligjore. Kjo duket edhe

ne mungesën në program të lëndëve klasike të programeve të drejtësisë si kriminalogji/penalogji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Në përputhje me kërkesat ligjore në nenin 18 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, IAL ka në përbërje të strukturës së tij akademike tre fakultete si më poshtë:

1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (më parë quhej “Fakulteti i Drejtësisë, Artit dhe Shkencave”);
2. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;
3. Fakulteti i Informatikës.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, sipas kërkesave të nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, përbëhet nga dy Departamente dhe një Qendër si më poshtë (Tabela 1 e Aneksëve):

1. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane;
2. Departamenti i Shkencave Sociale;
3. Qendra kërkimore për Shkencat Sociale.

Programi i studimit në fjalë ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Statuti i IAL-së në fjalë mban datën Prill 2017 dhe në nenin 9 reflekton të njëjtën strukturë akademike. Në bazë të nenit 11 të Statutit, Senati Akademik, si organi kolegjal më i lartë, drejtohet nga Rektori dhe mbidhet në mënyrë periodike. Në bazë të nenit 12 të Statutit, Senati orienton dhe mbështet politikat strategjike akademike të Institucionit. Në bazë të nenit 13 të Statutit, Senati përbëhet nga Rektori, dymbëdhjetë anëtarë nga njësitet kryesore si dhe një student i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve.

Dekani (i Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale), në bazë të nenit 17 të Statutit, emërohet dhe shkarkohet nga Bordi Administrativ i Institucionit bazuar në propozimin e Rektoratit dhe miratimin e Senatit Akademik. Sipas të njëjtit nen të Statutit, Dekani i Fakultetit duhet të ketë titullin “Profesor”. Në bazë të nenit 18 të Statutit, Dekani i Fakultetit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ndër të tjera Dekani, drejton Këshillin e Fakultetit, mbikëqyr zbatimin e procedurave të Institucionit nga stafi i Fakultetit, koordinon programin akademik duke vlerësuar përmbajtjen e programit, merr pjesë në rekrutimin e stafit akademik, merr pjesë në Rektorat dhe organe të tjera të universitetit etj. Këshilli i Fakultetit kryesohet nga Dekani dhe përbëhet nga Zv. Dekani, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë, një anëtar nga stafi jo-akademik, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.

Në bazë të nenit 21 të Statutit, Departamenti dhe Qendra Kërkimore Shkencore janë njësitet akademike bazë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Në bazë të nenit 22 të Statutit – i cili reflekton nenin 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë, Departamenti përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të punësuar më kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre duhet të kenë grada shkencore ose tituj akademike. Në bazë të nenit 23 të Statutit, që reflekton nenin 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë, drejtuesi i Departamentit, mban titullin “Profesor” ose “PhD” nga një universitet të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Drejtuesi i Departamentit, ndër të tjera, zhvillon strategjinë e Departamentit, përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore, mbikqyr mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, merr pjesë në rekrutim të stafit akademik.

Në dhjetor 2018 IAL ka miratuar rregulloren e programit të studimit në fjalë – nuk është e qartë nëse një rregullore e tillë ka ekzistuar dhe më parë. Rregullorja përcakton misionin e programit të studimit, objektivat bazuar në një paraqitje të kërkesave të tregut, strukturën e programit, mënyrën e vlerësimit të studentëve si dhe rregulla mbi plagjiaturën.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Sipas të dhënave të administruara dhe sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në Institucion, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka në përbërje të tij dy departamente dhe një Qendër. Për vitin akademik 2013-2014 nuk ka informacion lidhur me përbërjen e Qendrës Kërkimore për Shkencat Sociale. Secili nga departamentet dhe Qendra përbëhen nga të paktën 7 anëtarë personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët minimumi 3 kanë grada shkencore ose tituj. (Për më shumë shih Tabelat 2 dhe 3 të Anekseve). Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi një takim me Dekanen e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Drejtuesen e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. GVJ konstaton se Dekania e Fakultetit nuk është me titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës (Për informacion më të detajuar shih Tabelat 2 dhe 3)

Për vitin akademik 2013-2014, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale kishte në përbërje të tij **9 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 4 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 1 të nivelit LLM dhe **27 anëtarë PAK** prej të cilëve 3 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 13 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 6 Msc.

Për vitin akademik 2014-2015, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale kishte në përbërje të tij **9 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 1 "Profesor i Asociuar", 5 me gradën "Doktor", 1 Doktorant, dhe 1 LLM dhe **19 anëtarë PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 8 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 4 Msc.

Për vitin akademik 2015-2016, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale kishte në përbërje të tij **7 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor i Asociuar", 3 me gradën "Doktor", si dhe 3 Doktorantë dhe **16 anëtarë PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 1 me titullin "Profesor i Asociuar", 9 me gradën "Doktor", 2 Doktorantë dhe 2 Msc.

Për vitin akademik 2016-2017, Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale kishte në përbërje të tij **9 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor i Asociuar", 6 me gradën "Doktor" dhe 2 Doktorantë dhe **9 anëtarë PAK** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor i Asociuar", 4 me gradën "Doktor", 2 Doktorantë dhe 2 Msc.

Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane² kishte në përbërje të tij **8 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor i Asociuar", 3 me gradën "Doktor", 1 Doktorant, dhe 3 Msc. dhe **6 anëtarë PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 1 me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 3 me gradën "Doktor".

Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij **7 anëtarë PAE** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 2 me gradën "Doktor", 2 anëtarë me Msc si dhe 1 me LLM. dhe **7 anëtarë PAK** prej të cilëve 5 me gradën "Doktor" dhe 2 Doktorantë.

Në vizitën dhe takimin me Dekanen e Fakultetit dhe Drejtuesen e Departamentit, GVJ konstatoi se drejtuesja e Departamentit është me gradën "Doktor" sipas kërkesave të nenit 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Në bazë të nenit 5 të Statutit, Institucioni ka për qëllim dhe mision edukimin dhe zhvillimin e njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor. Sa më sipër do realizohet
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	

²Emërtim i ri i Departamentit.

Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;

Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".

me organizimin e studimeve në të tre ciklet universitare.

Për të përmbushur këtë mision dhe qëllim, Institucioni ka në përbërje të tij tre fakultete nga të cilët, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Humane dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale.

Sipas të dhënave nga viti akademik 2013 deri në vitin akademik 2019, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka patur dhe vazhdon të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore "Doktor".


Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Fakulteti dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit. Dekani i Fakultetit, si autoriteti më i lartë i njësisë kryesore, drejton Këshillin e Fakultetit, mbikqyr zbatimin e procedurave të Institucionit nga stafi i Fakultetit, koordinon programin akademik duke vlerësuar përmbajtjen e programit, merr pjesë në rekrutimin e stafit akademik, merr pjesë në Rektorat dhe organe të tjera të universitetit. Drejtuesi i Departamentit, ndër të tjera, menaxhon aktivitetin e njësisë bazë, është përgjegjës për zhvillimin e strategjisë së Departamentit, përgatit, në bashkëpunim me Dekanin dhe Rektorin, programet e lëndëve dhe shpërndarjen e orëve të mësimdhënies tek lektorët, kontrollon aktivitetet e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies etj.

Në bazë të nenit 24 të Statutit, Drejtuesi i Departamentit përcakton nevojat e Departamentit për staf të ri, koordinon këtë proces me Rektorin dhe Dekanin si dhe merr pjesë në vlerësimin e kandidatëve. Institucioni ka hartuar dokumentin "UNYT policy on faculty hiring". Sipas një shënimi në fund të dokumentit, këto procedura janë hartuar në bazë të dokumentit përkatës të aprovuar nga Senati, megjithatë në dokumentat e depozituar nuk ka evidencë të këtij dokumenti të Senatit. Ky dokument procedurash për rekrutimin e stafit akademik daton Janar 2017. Në bazë të dokumentit të sipërcituar, procedura e përzgjedhjes së stafit akademik nis nga përgjegjësi i departamentit dhe/ose dekani i/cili/a përcaktojnë nevojën për staf të ri akademik. Rektori ose një përfaqësues i tij kërkon aprovimin e Admistratorit. Pas procedurave aprovuese, njoftimi për vend të lirë pune shpallet publikisht brenda dhe jashtë vendit. Përgjegjësi i departamentit së bashku me staf akademik të fakultetit dhe një ekspert i jashtëm janë pjesë të komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.



Hapat e procesit të rekrutimit ilustrohen dhe nga shtojca no. 20 "Hiring Practice_Law position_B.B" depozituar nga institucioni si dokument shtesë. Gjithashtu, përfshirja e Departamentit në rekrutimin e personelit akademik u konfirmua dhe nga takimi me përfaqesuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila konfirmoi se nevojat si për PAE dhe për PAK përcaktohen brenda Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit njofton me email Zyrën e Burimeve Njerëzore lidhur me kërkesën për hapjen e një vendi të ri pune, si dhe kriteret dhe kushtet përkatëse (p.sh volumi i orëve të angazhimit). Dekani dhe drejtuesi i departamentit janë pjesë të komisionit *ad hoc* që ngrihet për rekrutimin e stafit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në përputhje me kërkesat ligjore, struktura e Institucionit konsiston në tre fakultete nga të cilët, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Humane dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale. Gjatë gjithë periudhës së vlerësuar në këtë raport, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka patur në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore "Doktor". Dekania e Fakultetit nuk mban titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë. Drejtuesja e Departamentit mban gradën "Doktor" sipas kërkesave të nenit 45 të Ligjit për Arsimin e Lartë.
2. Fakulteti dhe departamenti me drejtuesit përkatës përfshihen në realizimin e programit të studimit si dhe në procesin e rekrutimit të stafit akademik.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Programi i integruar Master i Shkencave në "Drejtësi" ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale. Referuar Statutit, Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale është i organizuar në 3 njësi bazë, Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale. Programi i integruar Master i Shkencave në Drejtësi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane, i cili gjithashtu ofron edhe 2 programe Master i Shkencave në "E Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare" dhe në "Marrëdhënie Ndërkombëtare". Rrjedhimisht personeli i brendshëm efektiv mbulon në ngarkesë njëkohësisht disa programe.

Departamenti që është dhe njësi përgjegjëse për ofrimin e programit të integruar Master në Drejtësi përmban numin minimal të nevojshëm që kërkon ligji prej 7 anëtarësh, numër që është ruajtur në të gjitha vitet e periudhës së vlerësimit (2013-2018). Kompozimi i departamentit dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë (PAK) ka ndryshuar në vite. Përgjithësisht në të gjitha vitet akademike që janë pjesë të vlerësimit, sipas të dhënave nga institucioni, Departamenti ka pasur në anëtarësi 7 anëtarë PAE kurse personeli PAK ka ndryshuar gjatë viteve. Pëmbushja e kërkesave ligjore në drejtëm të gradave dhe titujve rezulton në vite e ndryshme, përgjithësisht e një numri të vogël në raport me nevojat e një programi të integruar Master Shkencor në Drejtësi. Personeli ndihmës akademik në çdo vit ka qënë në numër relativisht të qëndrueshëm në intervalin 21-27 anëtarë, përveç vitit 2014-2015 në të cilin është ulur në 18 anëtarë, dhe në raport të përshtashtëm me personelin akademik dhe numrin e studentëve.



Në lidhje me procedurat e rekrutimit, rekrutimi bëhet mbi bazën e kërkesave të Kodit të Punës në lidhje me njoftimin, procedurën e rekrutimit, lidhjen e kontratës e termat e saj, etj. Rregulla mbi mënyrën e përcaktimit të nevojave për punësim, autoriteteve që përcaktojnë kriteret, ngritjen e komisioneve ad-hoc e kompozimin e tyre gjenden edhe në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.

Kontrata e punës për personelin PAE dhe PAK është e organizuar në pjesë, duke përkrahur lëndët në të cilat do të angazhohet personeli, të drejtat dhe përgjegjësitë, pasojat, mënyrën e zgjidhjes së kontratës. Në disa vite kontratat nuk kanë të njëjtat të dhëna në drejtim të numrit të orëve të angazhimit të personelit dhe përgjegjësitë përkatëse, ndërkohë që në vitin e fundit akademik ka një rregullim standard të kontratave në elementët e orëve, lëndëve në të cilën do të jete angazhimi, etj.

Institucioni zbaton rregullime të veçanta të ndryshme nga ato të parashikuara në Udhëzimin Nr. 20, datë 09.05.2008, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Udhëzimin e ri Nr. 9, datë 10.09.2018, i cili në pikën 5 të tij parashikon të drejtën e IAL jo publike për përcaktimin e ngarkesës minimale nga vetë institucioni. Numri i orëve për stafin e brendshëm siç rezultojn edhe nga angazhimi në lëndë arrin mesatarisht në 400-500 orë në auditor dhe aktivitete të tjera mbi këtë ngarkesë, kurse personeli i jashtëm angazhohet sipas lëndëve dhe ngarkesës përkatëse që është 45 orë për çdo lëndë por pa përcaktim të qëndrueshëm në çdo kontratë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në vitin akademik **2018-2019**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **19 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 7 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 7 Msc., dhe **7 PAK** prej të cilëve 5 me gradën "Doktor" dhe 2 Doktorantë.

Në vitin akademik **2017-2018**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **17 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 8 me gradën "Doktor" dhe **6 PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 1 me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 3 me gradën "Doktor".

Në vitin akademik **2016-2017**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **15 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 8 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 2 Msc dhe **8 PAK** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 1 Msc.

Në vitin akademik **2015-2016**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **15 PAE** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 4 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 3 Msc. dhe **14 PAK** prej të cilëve 3 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 6 me gradën "Doktor", 2 Doktorantë dhe 1 Msc.

Në vitin akademik **2014-2015**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **15 PAE** prej të cilëve 3 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 7 me gradën "Doktor" dhe 3 Msc. dhe **17 PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 6 me gradën "Doktor", 5 Doktorantë dhe 2 Msc.

Në vitin akademik **2013-2014**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **15 PAE** prej të cilëve 4 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 3 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 4 Msc. dhe **17 PAK** prej të cilëve 3 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar", 5 me gradën "Doktor", 4 Doktorantë dhe 3 Msc.

Përgjatë viteve akademike 2013-2016 ka pasur një angazhim të një numri pak më të lartë të personelit akademik të jashtëm me grada e tituj, sidoqoftë në vija të përgjithshme angazhimi i personelit akademik në program luhatet në masën 32-33 total personel i brendshëm dhe i jashtëm i programit në vitet akademike 2013-2016, dhe 22-23 total personel i brendshëm dhe i jashtëm i programit për vitet akademike 2016-2019. Në të dhënat më sipër, sidoqoftë janë mbajtur të përfshirë edhe anëtarët e personelit akademik që nuk plotësojnë kriterin ligjor të gradës për mësimdhënie në një program të integruar. Angazhimi i personelit PAE dhe PAK për të gjitha vitet akademike në vlerësim, raporti me personelin ndihmës akademik gjenden në tabelat 5 dhe 6 të Aneksëve.

Në lidhje me raportin PAE dhe PAK, në aspektin numerik, referuar të dhënave të Institucionit, raporti paraqitet si vijon:

2018-2019: 73.1 % PAE / 26.9 % PAK;
 2017-2018: 74 % PAE / 26 % PAK;
 2016-2017: 65.2 % PAE / 34.8 % PAK;
 2015-2016: 51.7 % PAE / 48.3 % PAK;
 2014-2015: 46.9 % PAE / 53.1 % PAK;
 2013-2014: 46.9 % PAE / 53.1 % PAK.

2 viteve më të fundit akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit është në linjë me kriterin 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program, konkretisht 17 PAE në raport me 6 PAK në 2017-2018 dhe 19 PAE në raport me 7 në 2018-2019. Në vitet e tjera ky raport nuk arrihet ose afrohet, konkretisht në vitin 2016-2017 ky raport është 15 PAE me 8 PAK, në vitin 2015-2016 është 15 PAE me 14 PAK, dhe në vitet 2014-2015 e 2013-2014 ky raport është i përmbysur 15 PAE me 17 PAK.

Duhet theksuar që në çdo vit akademik titullarë të lëndëve nga PAE përsëriten në një numër prej 5-6 lëndësh, në disa raste edhe në 8-9 lëndë. Kjo pa përfshirë anagazhimin që i njëjti personel akademik ka në programet Master Shkencor që ofrohen nga Departamenti e Fakulteti që nënkupton një ngarkesë edhe më të madhe të personelit akademik. Ka gjithashtu një problematikë në drejtim të përmbushjes së kriterëve për gradat e titujt të personelit që angazhohet në mësimdhënie në programin Master. Megjithëse duket të jetë në vëmendjen e Institucionit adresimi i kësaj nevoje, një numër titullarësh të lëndëve të personelit të brendshëm e të jashtëm kanë vetëm gradën shkencore Master Shkencor. Të dhëna të plota në lidhje me moshën, gradat e titujt sipas kategorive, janë pasqyruar në tabelat 5, 6, 7.1, 7.2 në Aneksat e Raportit.

Gjithashtu pranë programit asistojnë rreth 23 anëtarë personel staf administrativ, një numër i qëndrueshëm në vite pranë programit.

Përbërja e Këshillit Shkencor paraqitet në tabelën 4 të Aneksëve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Plani mësimor i lidhur me stafin akademik, i ndarë sipas viteve akademike (përfshirë tek tabelat në word)
- CV e pedagogëve: B. F; A K; A. Zh
- Kontratë I.P (pranverë 2015)
- Kontratë I.P (pranverë 2016)
- Faculty Selection Committee Meeting
- Faculty Selection Criterias and Procedures

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit; sidoqoftë programi ka një problematikë të ndjeshme në drejtim të numrit të ulët të stafit efektiv dhe në përgjithësi të të gjithë personelit akademik që ofron kurset e programit të integruar Master Shkencor në Drejtësi, duke bërë që një pedagog të ofrojë deri në 7-9 lëndë brenda programit. Kjo situatë është sidomos e ndjeshme në rastin e personelit të brendshëm, personel i cili përveç kësaj ngarkese ka edhe ngarkesë mësimore në programet Master Shkencor që ofron Departamenti, si Master në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare. Gjithashtu, në program përfshihet personel akademik që nuk zotëron grada e tituj sipas</p>

	<p>kërkesave ligjore për personelin akademik të programit të integruar Master Shkencor sipas akteve në fuqi.</p> <p>Për të gjitha sa më sipër, përmbushja e objektivave të programit është e diskutueshme; njëkohësisht edhe në drejtim të arritjes së objektivave strategjike për zhvillim të Institucionit mund të argumentohet se një ngarkesë e tillë afekton cilësinë dhe zhvillimin e profilit akademik e shkencor të personelit akademik të institucionit dhe ofrimin e një programi real të arsimit të lartë.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas informacioneve në institucion në diskutime me personelin akademik dhe drejtuesit mund të thuhet se përgjegjësia kryesore në hartimin e kurrikulës, literaturës, etj., qëndron tek personeli akademik i njësisë bazë.</p> <p>Sidoqoftë, mbetet i vlefshëm në lidhje me mungesën në Statutin e Universitetit të miratuar në vitin 2017 të parashikimeve mbi rolin dhe detyrat e Departamentit dhe vendimmarrjet e tij kolegjiale në drejtim të programeve që ofron si njësi akademike e shkencore përgjegjëse për këto programe.</p> <p>Sipas Statutit, në kompetencat e Drejtuesit të Departamentit përfshihet edhe përgatitja e programeve të kurseve në bashkëveprim me Dekanin dhe Rektorin e Institucionit. Nuk ka parashikime të qarta në Statut në lidhje me çështjen nëse ky rol është vetëm në fazën përfundimtare të procesit dhe sidomos rolin e lektorit në hartimin e kurrikulës së lëndës përkatëse dhe vendimmarrjes së Departamentit si njësi bazë akademike e shkencore.</p> <p>Sipas Statutit, një rregullore e veçantë për të drejtat e personelit akademik do të hartohet më tej në kohë, ndërkohë që të drejtat e personelit akademik sidomos në drejtim të lirive akademike dhe shkencore duhet të përfshihen në norma themelore në Statutin e Institucionit. Po kështu Statuti përmban parashikime në lidhje me kompetencat e Këshillit të Fakultetit në lidhje me miratimin e programeve të reja të studimit sipas fushave të departamenteve por nuk ka parashikime se cili është roli i departamentit në këtë proces.</p> <p>Rekrutimi dhe ngarkesa që parashikohet për personelin akademik të brendshëm e të jashtëm përmban problematikat e observuara në seksionet më sipër.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik rregullohet në drejtim të procedurave për rekrutim në Statutin e institucionit, nenet 38-41. Statuti përmban parashikime edhe për procedurën e rekrutimit të personelit ndihmës dhe atij administrativ. Nga takimi me stafin dhe konsultimi i dokumentacionit, përparësi i jepet personelit të kualifikuar sidomos në universitete të huaja, sidomos edhe për shkak të kriterit të njohjes së gjuhës angleze për qëllime të mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ka edhe rregullore mbi procesin e rekrutimit, megjithëse në rregullore mungon</p>

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

informacioni mbi kohën dhe autoritetin adoptues: siç është theksuar edhe më sipër, në përgjithësi në të gjithë dokumentacionin e programit mungon informacioni mbi subjektin aprovues dhe fuqinë e tyre, nuk përmbajnë firmë e vulë. Kontrata e punës është e organizuar në pjesë, duke përshkruar lëndët në të cilat do të angazhohet personeli, të drejtat dhe përgjegjësitë, pasojat, mënyrën e zgjidhjes së kontratës, etj. Në disa vite kontratat nuk kanë të njëjtat të dhëna në drejtim të numrit të orëve të angazhimit të personelit dhe përgjegjësitë përkatëse, ndërkohë që në vitin e fundit akademik ka një rregullim standard të kontratave në elementët e orëve, lëndëve në të cilën do të jete angazhimi, etj.

Në vitin akademik **2018-2019**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **19 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 7 me gradën "Doktor", 1 Doktorant dhe 7 Msc., dhe **7 PAK** prej të cilëve 5 me gradën "Doktor" dhe 2 Doktorantë.

Në vitin akademik **2017-2018**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **17 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 2 me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 8 me gradën "Doktor" dhe **6 PAK** prej të cilëve 2 me titullin "Profesor", 1 me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 3 me gradën "Doktor".

Në vitin akademik **2016-2017**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga: **15 PAE** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me titullin "Profesor i Asociuar", 8 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 2 Msc dhe **8 PAK** prej të cilëve 1 me titullin "Profesor", 3 me gradën "Doktor", 3 Doktorantë dhe 1 Msc.

Përgjatë viteve akademike 2013-2016 ka pasur një angazhim të një numri pak më të lartë të personelit akademik të jashtëm me grada e tituj, sidoqoftë në vija të përgjithshme angazhimi i personelit akademik në program luhetet në masën 32-33 total personel i brendshëm dhe i jashtëm i programit në vitet akademike 2013-2016, dhe 22-23 total personel i brendshëm dhe i jashtëm i programit për vitet akademike 2016-2019. Në të dhënat më sipër, sidoqoftë janë mbajtur të përfshirë edhe anëtarët e personelit akademik që nuk plotësojnë kriterin ligjor të gradës për mësimdhënie në një program të integruar. Angazhimi i personelit PAE dhe PAK për të gjitha vitet akademike në vlerësim gjendet në tabelat në fund të raportit.

Në lidhje me raportin PAE dhe PAK, referuar të dhënave të Institucionit, paraqitet si vijon:

2018-2019: 73.1 % PAE / 26.9 % PAK;

2017-2018: 74 % PAE / 26 % PAK;

2016-2017: 65.2 % PAE / 34.8 % PAK;

2015-2016: 51.7 % PAE / 48.3 % PAK;

2014-2015: 46.9 % PAE / 53.1 % PAK;
2013-2014: 46.9 % PAE / 53.1 % PAK.

2 viteve më të fundit akademike 2017-2018, dhe 2018-2019 personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit është në linjë me kriterin 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program, konkretisht 17 PAE në raport me 6 PAK në 2017-2018 dhe 19 PAE në raport me 7 në 2018-2019. Në vitet e tjera ky raport nuk arrihet ose afrohet, konkretisht në vitin 2016-2017 ky raport është 15 PAE me 8 PAK, në vitin 2015-2016 është 15 PAE me 14 PAK, dhe në vitet 2014-2015 e 2013-2014 ky raport është i përmbysur 15 PAE me 17 PAK.

Në drejtim të ngarkesës mësimore të programit, mund të thuhet se personeli PAE mbulon masën 85-90% të krediteve të programit në raport me ngarkesën e PAK, në mënyrë të ngjashme në të gjitha vitet akademike në vlerësim. Sidoqoftë kjo vjen nga ngarkesa me shumë lëndë e personelit të brendshëm; në çdo vit akademik titullarë të lëndëve nga PAE përsëriten në një numër prej 5-6 lëndësh, në disa raste edhe në 8-9 lëndë. Kjo pa përfshirë anagazhimin që i njëjti personel akademik ka në programet Master Shkencor që ofrohen nga Departamenti e Fakulteti që nënkupton një ngarkesë edhe më të madhe të personelit akademik.

Në drejtim të vlerësimit të personelit mund të thuhet se ka një sistem të përshtatshëm për vlerësimin e personelit në disa nivele: peer evaluation, vlerësimi nga ana e studentëve nëpërmjet pyetësorëve anonimë; kontrole rastësore dhe ka për qëllim kontrollin e elementëve të vlerësimit. Departamenti realizon gjithashtu edhe një monitorim vjetor që bazohet në të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e bëra gjatë vitit. Sipas të dhënave të dorëzuara nga Institucioni, Senati i Universitetit ka miratuar në mars të 2018 një rregullore mbi mënyrën e promovimit të personelit akademik bazuar në një vlerësim performance për qëllime të promovimit që nis në Departament e përmbyllet me vlerësimin e Rektorit, me të drejtën për apelim. Shefi i departamentit dhe dekani i nënshtrohen gjithashtu vlerësimit por në nivel rektorati. Gjithashtu institucioni përfshin një sistem vlerësimi të mënyrës së realizimit të procesit të vlerësimit përfundimtar në lëndë të studentëve, procedurë që kalon nga Shefi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit. Rubrikat e formularëve përfshijnë disa aspekte si mësimdhënia, kërkimi shkencor, apo kontributi institucional, në projekte, etj.

Institucioni mban një bazë të përshtatshme të të dhënave të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. ose postuniversitare jashtë vendit. Institucioni publikon vendet vakante dhe kriteret përkatëse në web site. Përdoret vlerësimi i bazuar në sistem pikëzimi.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i programit Master Shkencor ka gradën PHD. Ndërkohë siç u evidentua më sipër, ka një problematikë në drejtim të përmbushjes së kriterëve për gradat e titujt të personelit që angazhohet në mësimdhënie në programin Master. Megjithëse duket të jetë në vëmendjen e Institucionit adresimi i kësaj nevoje, një numër titullarësh të lëndëve të personelit të brendshëm e të jashtëm kanë vetëm gradën shkencore Master Shkencor. Sidomos në 2 vitet e fundit akademike për qëllime të arritjes së kriterit të gradës dhe titullit, ka një angazhim të theksuar të personelit me grada e tituj në një numër shumë të lartë lëndësh që nuk mund të realizohet dot cilësisht në këtë ngarkesë, në konsideratë gjithashtu edhe të kërimit shkencor që duhet të shoqërojë përgatitjen në lëndë. *(Të dhënat për çdo vit ndodhen në Aneksat e Raportit).*

Rektori, Zv/rektori, drejtori dhe Zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, Dekani, Zv/dekani, Drejtori, Përgjegjësi i Departamentit, Koordinatorja e programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimit. Duke pasur në konsideratë edhe numrin jo të lartë të studentëve në program mund të thuhet se në praktikë profesionale ka personel të mjaftueshëm për udhëheqje dhe mbikëqyrje.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;

Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Nga takimet me studentët e konsultimin e temave të dorëzuara në bibliotekë, mund të thuhet se studentët që ndjekin programin e integruar Master Shkencor në Drejtësi kanë udhëheqës për praktikën dhe punën kërkimore kryesisht nga personeli me gradën shkencore "Doktor" e sipër. Gjithashtu, nga vëzhgimi i punimeve dhe sipas konsultimeve në Institucion mund të thuhet se kufiri i numrit 5 është i aplikueshëm, kjo dhe për shkak të numrit të ulët të studentëve të programit përgjatë viteve.


Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Nga vëzhgimi i punimeve dhe sipas konsultimeve në Institucion mund të thuhet se angazhimi i pedagogëve mbikqyrës të temave të kërimit bëhet sipas fushës studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi dhe sipas kërkesave të programit të studimit.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.



<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi nuk përfshin orë laboratorike; siqodoftë nga konsultimi i dokumenatacionit dhe observimi në institucion mund të thuhet se në program ka një angazhim të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve të tilla si kërkim i pavaruar, përdorim i pajisjeve kompjuterike etj.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Në komunikimet pranë institucionit dhe vëzhgimit të kontratave të punës të personelit të brendshëm dhe të jashtëm rezultoi që në të dyja rastet Institucioni zbaton rregullime të veçanta të ndryshme nga ato të parashikuara në Udhëzimin Nr. 20, i datës 09.05.2008 i Ministrisë të Arsimit dhe Udhëzimin e ri Nr. 9, datë 10.09.2018, i cili në pikën 5 të tij parashikon të drejtën e IAL jo publike për përcaktimin e ngarkesës minimale nga vetë institucioni.</p> <p>Numri i orëve për stafin e brendshëm siç rezultoi edhe nga angazhimi në lëndë arrin mesatarisht në 400-500 orë në auditor dhe aktivitete të tjera mbi këtë ngarkesë, kurse personeli i jashtëm angazhohet sipas lëndëve dhe ngarkesës përkatëse që është 45 orë për çdo lëndë por pa përcaktim të qëndrueshëm në çdo kontratë.</p> <p>Sidoqoftë, në konsultim me orarin e lëndëve dhe komunikimet me studentët e programit rezultoi një angazhim në auditor për 5 lëndë në javë në 3 orë sipas studentëve duke arritur në ngarkesën në numrin 15 orë/javë, që është më e ulët se kërkesat e Udhëzimit Nr. 15, datë 4.4.2008 "Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" dhe Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Gjithashtu, disponohet për secilin semestër lista e plotë e personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.</p> <p>Në drejtim të kriterëve dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, ato janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren për Rekrutimin e Personelit Akademik. Thirrjet janë publike në përmbushje të kërkesave të kuadrit ligjor në fushën e arsimit të lartë dhe kërkesave të Kodit të Punës.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Angazhimi i personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit; sidoqoftë programi ka një problematikë në drejtim të numrit të ulët të stafit efektiv dhe në përgjithësi të të gjithë personelit akademik që ofron kurset e programit të integruar Master Shkencor në Drejtësi. 2. Rregullat mbi procesin e rekrutimit, vlerësimit të performancës dhe rolit të stafit pedagogjik në programin e integruar Master Shkencor në Drejtësi parashikohen në Statut dhe në rregulloret përkatëse të Institucionit; 	

3. Statuti i Universitetit i miratuar në 2017 duhet të përmbajë parashikime mbi rolin dhe detyrat e Departamentit, vendimmarrjet e tij kolegjiale në drejtim të programeve që ofron si njësi akademike e shkencore përgjegjëse për këto programe.
4. Në lidhje me raportin numerik PAE dhe PAK, vetëm në 2 vitet e fundit akademike PAE i angazhuar për realizimin e programit është në linjë me kriterin 70% të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe në mbulimin në masën 85-90% të krediteve të programit por kjo vjen edhe si rrjedhojë e angazhimit të personelit efektiv në një numër të madh lëndësh.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në bazë të RVB (fq. 37) por dhe sipas bisedave në IAL, nga viti 2015 Institucioni ka kampusin e ri qendror që ndodhet te Kodra e Diellit. Ky kampus është marrë nga IAL me qera afatgjatë. Ekziston plani për ndërtimin e një kampusi të madh me qëllim përfshirjen e të gjitha cikleve të studimit në një godinë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ vizitoi bibliotekën, sekretarinë mësimore, salla mbledhësh, salla leksionesh e seminaresh si dhe laboratorin e informatikës (dokumenti "Planimetria", Aneks 11.1 i DVV) Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ofron vende për lexim dhe një fond me libra kryesisht në gjuhën angleze. Përballë bibliotekës gjendet salla me kompjutera dhe fotokopje e cila është në dispozicion të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Për më shumë shih Tabelën 8)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin (Për më shumë shih Tabelën 9)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

GVJ vizitoi kampusin ku zhvillohet e gjithë veprimtaria akademike dhe administrative e Institucionit. Biblioteka është ngritur në nivel institucioni dhe në të ndodhen ambiente leximi. Biblioteka shërben nëpërmjet literaturës fizike dhe asaj elektronike. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ verifikoi ambientet e bibliotekës e cila ofron tituj të ndryshëm lidhur me programin e studimit në fjalë. Me kërkesë të GVJ, institucioni vuri në dispozicion listën e titujve në gjendje në bibliotekë lidhur me programin e Drejtësisë.

Nga shqyrtimi i listës së librave si dhe nga kërkimi në faqen e internetit të bibliotekës, vihet re se Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik titujt kryesorë të së drejtës kombëtare, ndërkombëtare dhe europiane. Megjithatë, është i nevojshëm përditësimi i titujve në bibliotekë. P.sh, nga një kërkim në faqen e internetit të bibliotekës -<http://library.unyt.edu.al/index.php> me togfjalëshin "EU law" rezulton se "EU Law: Text, Cases, and Materials" nga Paul Craig dhe Grainne De Burca dhe që gjendet në bibliotekë, është një bonim

i vitit 2011, ndërkohë që botimi më i fundit i takon vitit 2015. Nga një kërkim më togfjalëshin "Comparative constitutional law" dhe "Constitutional law" bien në sy botime të rëndësishme si ai i vitit 1979 nga M. Cappelletti dhe W. Cohen, libri nga L. Prakke, C. A. J. M. Kortmann, J. C. E. van den Brandhof i vitit 2004 (botimi i përditësuar është i vitit 2014, por jo në bibliotekë), libri nga A. W. Heringa dhe P. Kiiver i vitit 2007, libri nga M. Rosenfeld dhe A. Sajó i vitit 2012, libri nga T. Ginsburg dhe R. Dixon i vitit 2012. Në mënyrë të ngjashme, nga një kërkim me togfjalëshin "International law" rezulton se titujt kryesorë të së drejtës ndërkombëtare si "Principles of Public International Law" e Ian Brownlie ose "Blackstones International Law Documents" e Malcom Evans gjenden në bibliotekë në disa kopje. Megjithatë, titulli më i ri nga kategoria "International Law" i përket vitit 2009. Sa më sipër ilustron se biblioteka është e pajisur me literaturën e huaj bazë e cila mund të shërbejë si një bazë studimi dhe kërkimi shkencor, megjithatë nuk është e mjaftueshme duke parë përditësimin e titujve shkencorë ndërkombëtarë.

Nga një studim i detajuar i listës së lëndëve (*syllabuse*) dhe listës së librave që gjenden në bibliotekën e institucionit dhe nga kërkimi online në bibliotekë, rezulton se jo gjithmone librat e vendosur si literaturë e detyrueshme gjenden në bibliotekë. Për shembull, rezulton se librat/titujt e mëposhtëm nuk janë pjesë e fondit:

Lënda: Administrative Procedure

S.Sadushi - E Drejta Procedurale Administrative, Një analizë mbi Kodin e Procedurave Administrative;
S.Sadushi - Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën.

Lënda: Advanced Legal Writing and Reasoning

S. Camp - College English and Business Communication;
A. Bradney - How to study law;
D. Powell & E. Teare - Writing for law;
J. Holland, and J. Webb - Learning Legal Rules; A Student's Guide to Legal Method and Reasoning;
L. Cherkassky et al - Legal Skills;
N. Corbett-Jarvis and B. Crigg - Effective Legal Writing: A Practical Guide.

Lënda: Albanian Business and Law

A. Nuni - Business Law;
J. Rush and M. Otteley - Business Law;
T. Ben Holland and E. Oldashi - Commentary on Albanian Company Law;
A. Bennett - Employment Law for Business.

Lënda: Anthropology and Justice

Roach (2000) - Law and Social Change;
Kuppe, Potz, (2005) - Law and Anthropology. International Yearbook for Legal Anthropology.

Lënda: Civil Law I

Mousourakis, George - Fundamentals of Roman private law;
Nuni, Ardian - E drejta Civile (pjesa e përgjithshme);
Stolker, C. J. J. M - Drafting a new Civil Code for Albania-Some personal experiences contrasted with the World Bank's Initial lessons;
Trnavci, Genc H - The Albanian customary law and the canon of Lekë Dukagjini: A clash or synergy with modern law;
Twigg-Flesner, Christian, ed. -The Cambridge companion to European union private law.

Lënda: Civil Procedure

Brati A. (2009) - E Drejta Procedurale, Tirana;
Cound et al. (2008) - Civil Procedure;
Friedenthal, Miller, Sexton & Hershkoff - Civil Procedure: Cases and Materials (9th ed. 2005:Thompson/West);
Friedenthal, Miller, Sexton & Hershkoff - Civil Procedure Supplement, 2007;
Glannon J.W. (2008) - Civil Procedure Examples and Explanations, 6th edition, Aspen Publishers;
James F., Hazard G.C., Leubsdorf J. (2001) - Civil Procedure, 5th ed., West Publishing;
Marcus R.L., Redish M.H., Sherman E.F. and Pfander J.E. (2009) - Civil Procedure: A Modern Approach, 5th ed., West Publishing;
Shreve G.R. (2009) - Understanding Civil Procedure, LexisNexis/Matthew Bender;
Spencer B. (2008) - Civil Procedure: A Contemporary Approach, 2nd edition, Thomson West Publishing;
Subrin S.N. et al. (2008) - Civil Procedure: Doctrine, Practice and Context, 3rd edition, Aspen Publishers.

Lënda: Criminal Law I

Elezi, I., Kaçupi, S. & Haxhia, M. (2009) - Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Lënda: Domestic and International Bankruptcy Law

Milman, David - Corporate Insolvency: Law and Practice, London: Sweet & Maxwell;

Wall Jeffrey - Cross-Jurisdictional Remands.

Në lëndë të tjera si psh Constitutional Law, Comparative Public & Constitutional Law, Criminal Law II tekstet gjenden në bibliotekë.

Gjithashtu vihet re një mospërputhje midis listës së librave dhe bazës së të dhënave online të bibliotekës lidhur me tituj të botuar nga Shtëpia botuese e librit universitar në vitin 2018 dhe që lidhen me programin e studimit: këto tituj rezultojnë në listën e librave të paraqitur nga institucioni, por nuk rezultojnë në bibliotekë nga kërkimi që bëhet online.

Në takimin me studentët u konfirmua që biblioteka u vjen në ndihmë studentëve duke vënë në dispozicion kopje të librave si dhe duke u dhënë studentëve mundësinë të bëjnë fotokopje të teksteve.

Një ndër objektivat strategjike të Planit Strategjik 2018-2022 është dhe investimi në infrastrukturë, posaçërisht në pasurimin e bibliotekës, rritje të aksesit në bibliotekat elektronike, përfshirje e stafit akademik në përditësimin e titujve të bibliotekës si dhe organizimi i vizitave në bibliotekë për të familjarizuar studentët me burimet ekzistuese.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

– Listë e botimeve që ndodhet pranë bibliotekës, literaturë në lëndët e programit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore; Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet; Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron; Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Që nga viti 2015 vendndodhja e Institucionit është tek Kodra e Diellit në një kampus i cili është marrë me qera afatgjatë nga Institucioni. Ky kampus është në dispozicion të institucionit në tre vitet e fundit, por rezulton se mund të jetë i tillë dhe në të ardhmen duke qenë se bazohet në qera afatgjatë. Institucioni garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura për të përmbushur nevojat e mësimdhënies. Gjatë takimit në institucion u përmend plani i ndërtimit të një kampusi të madh në të cilin do të mund të përfshihen të gjitha ciklet në një godinë.
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore; Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës; Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të	Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit në fjalë bibliotekën me ambiente leximi, tekste dhe materiale elektronike. Përditësimi i titujve mbetet sfida e vazhdueshme. Edhe pse biblioteka ka një larmi titujsh që i shërbejnë programit të studimit, një pjesë e mirë e tyre nuk janë të përditësuar dhe për rrjedhojë nuk reflektojnë zhvillimet më të fundit të debatit akademik. Për disa lëndë të programit, literatura e detyrueshme gjendet në bibliotekë, ndërsa për lëndë të tjera jo. Në

<p>studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>përgjithësi biblioteka është e pajisur me tituj në shqip, duke qenë se pjesa më e madhe e lëndëve trajtojnë aspekte të legjislacionit të brendshëm shqiptar.</p> <p>Një ndër objektivat strategjike të Planit Strategjik 2018-2022 është dhe investimi në infrastrukturë, posaçërisht në pasurimin e bibliotekës, rritje të aksesit në bibliotekat elektronike, përfshirje e stafit akademik në përditësimin e titujve të bibliotekës si dhe organizimi i vizitave në bibliotekë për të familjarizuar studentët me burimet ekzistuese. Megjithatë, ky dokument nuk përmban një buxhet të detajuar për këtë qëllim.</p> <p>Biblioteka u shërben studentëve në çdo ditë të javës dhe u vjen në ndihmë studentëve në përputhje me nevojat e tyre.</p>
<p>Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve klasa, salla leksioni, bibliotekën, laboratorin e informatikës si dhe zyra për stafin administrativ.</p> <p>Mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies në të gjitha format e saj, mbështetur edhe nga teknologjia.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ofron infrastrukturë të qëndrueshme dhe mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura për zhvillimin normal të veprimarisë mësimore, kërkimore dhe administrative. 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ofron tituj leximi në sallë dhe bazë të dhënash elektronike. Për disa lëndë të programit në fjalë, literatura e detyrueshme nuk ofrohet në bibliotekën e Institucionit. Nevojitet përditësim i fondit të bibliotekës me tituj që pasqyrojnë zhvillimet më të fundit të debatit akademik. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas të dhënave të sigurara nga Institucioni, burimet kryesore të financimit janë në masën më të madhe tarifatat e shkollimit që sigurohen nga studentët, grante për kërkim shkencor dhe në një masë të vogël të ardhura të siguruar nga veprimtari tregtare (kafe, bare, etj.) Të ardhurat çdo vit shkojnë në masën dërrmuese në paga e shpenzime dhe më pak në investime për institucionin. Kostoja për student për çdo vit akademik në vlerësim, duke nisur nga viti akademik 2013-2014 rezultojnë pak a shumë e qëndrueshme në limitet e 3000-3400 euro. Në drejtim të menaxhimit institucioni ka themeluar Zyrën Financiare, e cila realizon zbatimin e politikave financiare.

Zyra
Doniula Ripa

është përgjegjëse për procesin e menaxhimit financiar dhe informacioni që gjeneron Zyra shërben për vlerësimin e menaxhimit financiar të institucionit, stabilitetin e qëndrueshmërisë së tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi sipas të dhënave të marra nga Institucioni:

Në të dhënat e dorëzuara nga institucioni për periudhën 2012-2017, burimet kryesore të të ardhurave rezultojnë tarifatat e shkollimit, grantet për kërkim shkencor si edhe kontratat për aktivitete tregtare (mensa, kafe, bar, rezidenca). Mungojnë të dhëna të plota për vitin 2018 për shkak të analizës së mëvonshme të këtij viti. Të dhëna të detajuara për të ardhurat dhe financimet në këtë program studimi paraqiten në tabelën 10 të Anekseve.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të ardhurat shkojnë kryesisht në shpenzime për personelin, shpenzime konsumi dhe amortizimi, shpenzime të tjera shërbimesh, qera, kancelari, reklama, shërbime konsulence etj. Të dhëna të detajuara në lidhje me kostot për çdo vit akademik paraqiten në tabelën 11.1 dhe 11.2 të Anekseve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Sipas të dhënave të dorëzuara, rezultojnë se veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm i cili realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar. Gjithashtu në dokumentacion jepen të dhëna në lidhje me mënyrën e përdorimit të të ardhurave të funksionit të veprimtarive të Institucionit për realizimin e programeve të ofruara.</p> <p>Institucioni realizon edhe një audit vjetor të brendshëm për vlerësimin e mënyrës së menaxhimit të të ardhurave dhe përmbushjen e qëllimeve të përdorimit të tyre etj. Sipas dokumentacionit në institucion, ky auditim realizohet nga një komision i emëruar nga Bordi i Aksionerëve të Institucionit. Në të dhënat e dorëzuara nga institucioni për periudhën 2012-2017, burimet kryesore të të ardhurave rezultojnë tarifatat e shkollimit, grantet për kërkim shkencor si edhe kontratat për aktivitete tregtare (mensa, kafe, bar, rezidenca). Mungojnë të dhënat për vitin 2018 për shkak të analizës së mëvonshme të këtij viti.</p> <p>Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të ardhurat shkojnë kryesisht në shpenzime për personelin, shpenzime konsumi dhe amortizimi, shpenzime të tjera shërbimesh, qera, kancelari, reklama, shërbime konsulence etj.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p>	<p>Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar Institucioni përpilon raporte të përvitshme financiare dhe në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit.</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Sidoqoftë perspektiva mbetet e lidhur me numrin e studentëve që do ta zgjedhin Institucionin për të vijuar studimet Master, program i cili ka pësuar një ulje përgjatë viteve.</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm që realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar; në Raport paraqitet e gjithë situata financiare në përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të ofruara. Përveç auditimit të jashtëm realizohet edhe audit vjetor i brendshëm në lidhje me menaxhimin e të ardhurave, përmbushjen e qëllimeve të përdorimit të tyre, etj. i cili realizohet nga një komision i emëruar nga Bordi i Aksionerëve të Institucionit.
2. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar, Institucioni përpilon raporte të përvitshme financiare dhe në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor. Sidoqoftë, perspektiva është e lidhur me tërheqjen e studentëve për të vijuar studimet Master, program i cili ndër vite ka pësuar një ulje.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë përfshin Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit ("Komisioni"), si një organ i përhershëm dhe Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë. Në bazë të nenit 28 të Statutit të institucionit, ky Komision zgjidhet nga Senati Akademik dhe është përgjegjës për "koordinimin e procedurave për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike, kërkimit shkencor dhe të IAL". Sipas nenit 29 të Statutit, Njësia e Sigurimit të Cilësisë "vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore." Sipas të njëjtit nen "në fund të çdo semestri ose përpara çdo provimi organizon vlerësimet e studentëve. Në bazë të ketyre pyetësorëve dhe informacionit të mbledhur kjo njësi përgatit raportin e vlerësimit vjetor". Në bazë të nenit 29 të Statutit, kjo Njësi, së bashku me njësi të tjera administrative të Institucionit, vlerëson progresin e punësimit të studentëve dhe efencën e programeve të ofruara nga Institucioni. Komisioni funksionon në bazë të Manualit për Sigurimin e Cilësisë që është hartuar nga vetë Komisioni dhe është i vitit 2018.

Në bazë të nenit 28 të Statutit, Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë (por jo më shumë se 7), me një mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Një nga anëtarët vjen nga rradhët e studentëve. Aktualisht ky Komision përbëhet nga 7 anëtarë ndër të cilët: kryetarja aktuale e Komisionit, nga një përfaqësues nga secili Fakultet; një ekspert i jashtëm; një përfaqësues të studentëve; si dhe Koordinatorja e Zyrës së sigurimit të cilësisë (për me tepër, shih Tabelën 12). Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati një takim me Kryetaren e Komisionit, një anëtare si dhe Koordinatorin e Zyrës së sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Vlerësimet nga studentët përbëjnë një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së Komisionit. Këto vlerësime kryhen në mënyrë periodike (për çdo semestër) dhe sipas RVB, koordinohen nga asistentja e rektorit dhe koordinatorja e zyrës së sigurimit të cilësisë. Kjo u konfirmua gjatë takimit me përfaqësuesit e Komisionit si dhe nga takimi me studentët të cilët pohuan se vlerësimi i lëndës ndodh në fund të çdo lënde dhe organizohet në mënyrë anonime. Gjithashtu ky fakt ilustron dhe nga shtojca 7 "Evaluation Form" si dhe shtojcat 13 dhe 14 "Shembuj të vlerësimeve nga studentët për kursin x" dhe "Shembuj të vlerësimeve nga studentët për kursin y" të marra në Institucion.

Dokumenti në shtojcën 19 “Rezultatet e vlerësimeve të studentëve _ Performance from Fall 2014 Spring 2018” paraqet një pasqyrë të përgjithshme të vlerësimeve të studentëve për çdo lëndë për periudhën 2014-2018. Performancës së secilit pedagog i korrespondon një numër, i cili, sipas bisedës në institucion, tregon performancën e pedagogut në një shkallë nga 0-60 pikë. Ky dokument nuk përmban analizë cilësore të performancës së pedagogëve si dhe konkluzione mbi vlerësimin dhe propozime për hapa të mëtejshëm.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë bëhet nga Komisioni dhe bazohet në 5 shtylla kryesore:

- 1) *peer evaluation* që është një vlerësim mes kolegësh;
- 2) vlerësimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve anonimë;
- 3) kontrolli i transparencës së vlerësimit që bazohet në kontrole rastësore dhe ka për qëllim kontrollin e elementëve të vlerësimit;
- 4) vlerësimi individual i stafit akademik;
- 5) raporti vjetor i Komisionit që është një përmbledhje e raporteve vjetore të Departamenteve.

Peer evaluation si një vlerësim mes kolegësh mund të jetë i befasishëm ose në bazë të një njoftimi. Qëllimi i vlerësimit është kontrolli i përmbajtjes së mësimdhënies dhe metodologjisë si dhe dhënia e komenteve për përmirësim. Formulari përkatës plotësohet, kalohet te përgjegjësi i departamentit dhe më pas i dërgohet Komisionit. Institucioni ka depozituar një formular të tillë si shembull (Shtojca 9).

Kontrolli i transparencës së vlerësimit ka për qëllim kontrollin e vlerësimit të dhënë nga pedagogët. Përzgjedhja e lëndëve që i nënshtrohen kontrollit të transparencës së vlerësimit bëhet nga drejtuesi i departamentit në mënyrë rastësore dhe më pas reflektohet në një raport po nga Departamenti. Nga dokumentacioni i dosjes, GVJ shqyrtoi raportin e dt. 5.4.2018 “*Grading Fairness, Transparency, Comparability*” (Shtojca 22) për periudhën semestri i vjeshtës 2017. Nga shqyrtimi i këtij raporti, vihet re nga pikëpamja formale që mungojnë emrat e personave të cilët e kanë hartuar raportin, mungon miratimi nga përgjegjësi i departamentit si dhe autorizimi nga Dekani (të gjitha kërkesa të formularit). Ky raport nuk është i firmosur. Raporti nuk ka evidentuar probleme me vlerësimin nga pedagogët.

Vlerësimi individual i stafit akademik ka për qëllim vetë-reflektimin nga ana e pedagogut lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor si dhe shërbime të tjera për Institucionin si dhe pjesëmarrje në aktivitete për zhvillimin profesional të pedagogut. Ky vlerësim që bëhet në bazë të një formulari (Shtojca 20) bëhet pjesë e performancës së përgjithshme të pedagogut nga punëdhënësi.

Puna e Komisionit, bazohet në Manualin për Sigurimin e Cilësisë, i cili është një dokument përshkrues i parimeve të përgjithshme të sigurimit të cilësisë. Ky dokument përcakton Senatin akademik si organi akademik më i lartë që ka përgjegjësinë për miratimin, kontrollin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Manuali duhet të kondensohet më tej dhe të përmbledhë procedurat konkrete dhe ndarjen e roleve midis organeve në këto procedura. Në manual (fq. 14) del qartë që Komisioni harton një raport vjetor vetëvlerësimi institucional dhe të programit, por nuk përcakton më tej se ku paraqitet ky raport. Manualit për Sigurimin e Cilësisë i janë bashkëngjitur formularë të rishikimit të syllabus-eve; peer – review të mësimdhënies; formularë vlerësimi nga studentët; model i raportit vjetor të departamentit. Megjithatë, Manuali nuk përcakton në mënyrë të qartë një plan veprimi të organizuar në kohë, organet përgjegjës dhe hapat që duhen ndjekur në rast se raportet evidentojnë probleme.

Në dosje është administruar “Raporti vjetor i sigurimit të cilësisë” për vitin akademik 2017-2018 miratuar nga Komisioni i Sigurimit të cilësisë (Shtojca 18.1). Gjithashtu në nivel departamenti, dosja përmban dhe Raportin vjetor të monitorimit të Departamentit për vitin akademik 2017-2018. Nuk ka evidencë të raporteve vjetore qoftë të Komisionit, qoftë të Departamentit për vitet e mëparshme akademike. Gjithashtu, ky raport vjetor i departamentit nuk përmban firmat e hartuesve si dhe nuk është aprovuar nga Përgjegjësi i Departamentit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Raporti vjetor i sigurimit të cilësisë për vitin akademik 2017-2018 i hartuar nga Komisioni, përmban statistika të numrit të vlerësimeve nga studentët për të gjitha programet, një pasqyrë të vlerësimeve për transparencën e notës, një përmbledhje të *peer evaluation* ku paraqitet lënda e kontrolluar dhe pedagogu vlerësues, elementët që duhet të përmbajë një raport vjetor i departamentit. Bie në sy që këto pasqyra të vetëvlerësimeve janë përgjithësisht

përshkruese dhe sasiore dhe nuk evidentojnë gjetje apo rezultate konkrete. Gjithashtu, në përfundim të raportit vjetor, Komisioni ka listuar një sërë rekomandimesh për përmirësim, por që mbeten në nivel të përgjithshëm. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni sugjeron që Institucioni të ndërmarrë veprime të mëtejshme lidhur me sugjerimet e procesit të vlerësimit të studentëve për të garantuar transparencën dhe konfidencialitetin. Këshillohet që të rritet numri i trajnimeve për sigurimin e cilësisë, të shtohen kanalet e komunikimit midis niveleve të ndryshme të administratës, njësisia e sigurimit të cilësisë duhet të ketë më shumë staf, të sigurohet më shumë koherencë në informacionin që u jepet studentëve, më shumë transparencë dhe komunikim të informacioneve online dhe publikim të raporteve të vlerësimit të jashtëm etj, një vlerësues i jashtëm duhet të përfshihet në këtë proces. Nuk është e qartë çfare nënkuptohet konkretisht me rekomandimin e tretë që lidhet me kanalet e komunikimit ose me rekomandimin e gjashtë që lidhet me transparencën.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Gjatë bisedës me përfaqësues të NJSBC, GVJ u interesua lidhur me evidenca që tregojnë ekzistencën e një cikli të mbyllur të sigurimit të cilësisë në Institucion. Lidhur me këtë, Institucioni vuri në dispozicion dokumentin "Kërkesë drejtuar Senatit Akademik nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë" (Shtojca 2) e dt. 10/05/2018. Ky dokument përmban pikat e mëposhtme si propozime drejtuar Senatit Akademik: Kontrolli *peer review* duhet të bëhet çdo vit; menaxhimi i vlerësimeve të studentëve duhet të kalojë nga një person në një komision i përbërë nga staf akademik, staf administrativ dhe një përfaqësues i studentëve; student handbook duhet të unifikohet; faja e parë e provimeve duhet të unifikohet; vendosja e një anëtarit të jashtëm të NJSBC; përdorimi i një sistemi të përditësuar të të dhënave si dhe unifikimi i të dhënave dhe procedurave të programeve master dhe bachelor që lidhen me Sekretarinë mësimore me qëllim lehtësimin e monitorimit nga NJSBC.

Në mbledhjen e dt. 2.11.2018, Senati Akademik mori në shqyrtim pikën lidhur me menaxhimin e vlerësimeve të studentëve, por në përfundim vendosi që ky propozim të shqyrtohej në mbledhjen e Rektoratit. Në dosje nuk ka dokumente apo "gjurmë" të vendimmarrjes nga Rektorati lidhur me këtë çështje.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Kërkesë drejtuar Senatit Akademik nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë
- Raporti vjetor i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë (PCAQSI) 2017-2018
- Shembuj të vlerësimeve nga studentët për kursin x
- Shembuj të vlerësimeve nga studentët për kursin y
- Mbledhje e Senatit Akademik, diskutimi i kërkesës së Komisionit të Sigurimit të Cilësisë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit në fjalë. Këtu mund të përmendim <i>peer evaluation</i> që është një vlerësim mes kolegësh; vlerësimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve anonimë; kontrolli i transparencës së vlerësimit që bazohet në kontrole rastësore dhe ka për qëllim kontrollin e elementëve të vlerësimit; vlerësimi individual i stafit akademik. Ky informacion përfshihet në Raportin vjetor të Komisionit që është një përmbledhje e raporteve vjetore të Departamenteve si dhe në "Raporti vjetor i monitorimit të departamentit" për vitin akademik 2017-2018. Institucioni përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta.</p> <p>Nuk ka evidencë të raporteve vjetore qoftë të Komisionit, qoftë të Departamentit për vitet e mëparshme akademike, me përjashtim të vitit akademik 2017-2018. Gjithashtu, raporti vjetor,</p>

- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

departamentit nuk përmban firmat e hartuesve si dhe nuk është aprovuar nga Përgjegjësi i Departamentit.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Institucioni synon të sigurojë cilësinë e programit të studimit nëpërmjet një strukture të qëndrueshme si Komisioni për sigurimin e cilësisë. Komisioni bazohet mbi Manualin e Sigurimit të Cilësisë, i cili përshkruan në mënyrë të përgjithshme parimet e sigurimit të cilësisë por nuk përmban një plan veprimi të mirëpërcaktuar lidhur me procedurat dhe hapat që duhet të ndërmerren gjatë vitit akademik nga aktorët e ndryshëm lidhur me kontrollin e brendshëm të sigurisë. Departamenti dhe Komisioni kanë hartuar respektivisht një raport vetëvlerësimi për vitin 2017-2018.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Institucioni dhe Departamenti kanë hartuar dhe publikuar një raport vjetor për 2017-2018 ku vlerësohet ecuria e zhvillimit të institucionit dhe programit. Departamenti dhe Komisioni kanë hartuar respektivisht një raport vetëvlerësimi për vitin 2017-2018. Megjithatë çfarë bie në sy në raportin e Komisionit është natyra përshkruese e këtij raporti dhe mos pasja e gjetjeve apo rezultateve konkrete. Gjithashtu, në përfundim të raportit vjetor, Komisioni ka listuar një sërë rekomandimesh për përmirësim, por që përgjithësisht mbeten në nivel të përgjithshëm.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

David Ligaj

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashërme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit në fjalë. Institucioni ka krijuar Komisionin e sigurimit të cilësisë si njësi të përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi vepron mbi bazën e një manuali, por që nuk përmban një plan veprimi të detajuar. Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion dëshmon për ekzistencën e mekanizmave për kontrollin e sigurisë si vlerësimet e studentëve, vlerësimet mes kolegëve, kontrolli i transparencës së vlerësimit dhe fokus grupet.</p> <p>Siç është përmendur dhe më lart, ka një rast kur Komisioni i është drejtuar me një kërkesë Senatit Akademik (Shtojca 2, dokument i dt. 10/05/2018). Ky dokument përmban disa sugjerime të Komisionit për Senatin, nga të cilat vetëm ai lidhur me menaxhimin vlerësimeve të studentëve u diskutua nga Senati në mbledhjen e dt. 2/11/2018. Megjithatë edhe lidhur me këtë pikë Senati vendosi që ky propozim të shqyrtohej në mbledhjen e Rektoratit. Në dosje nuk ka dokumente apo "gjurmë" të vendimmarrjes nga Rektorati lidhur me këtë çështje apo lidhur me çështjet e tjera të ngritura nga Komisioni.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni përdor metodologji (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit në fjalë. 2. Institucioni dhe Departamenti përkatës kanë publikuar një raport vjetor vlerësimi për vitin akademik 2017-2018. Nga pikëpamja formale, raporti vjetor i departamentit nuk përmban firmat e hartuesve si dhe nuk është aprovuar nga Përgjegjësi i Departamentit. 3. Komisioni i sigurimit të cilësisë është krijuar si njësi e përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi vepron mbi bazën e një manuali, por që nuk përmban një plan veprimi të detajuar. Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion dëshmon për ekzistencën e mekanizmave për kontrollin e sigurisë si peer evaluation, vlerësimet e studentëve, kontrolli i transparencës së vlerësimit, vetëvlerësimi individual. Raporti vjetor i Komisionit është përgjithësisht përshkrues dhe bën një paraqitje me shumë sasiore të kontrolleve. Në një rast të një kërkesë drejtuar Senatit akademik për përmirësim në sistemin e menaxhimit të vlerësimeve nga studentët, Senati nuk vendosi vetë por ia kaloi çështjen Rektoratit. Nuk ka evidencë në dosje për një vendimarrje të Rektoratit lidhur me këtë çështje. 	


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Sipas rregullores së Programit të Integruar Master Shkencor, qëllimi i tij është përgatitja e studentëve me njohuri në fushën e drejtësisë në qasje komplementuese të sistemit juridik të familjes romano-gjermane dhe common law.

Programi në mënyrën e ndërtimit të tij ka objektiv ofrimin në treg të të diplomuarve në fushën e së drejtës, të përgatitur me anë të një programi të larmishëm në disiplina në gjuhë të huaj anglisht, që do t'i mundësojë të diplomuarve aksesin literaturë të avancuar në gjuhë të huaj, duke synuar edhe lehtësimin e vijimit të mëtejshëm të studimeve në programe të tjera në gjuhë të huaj.

Organizimi i programit të integruar përfshin 300 kredite të ndara në 5 vite, në lëndë që kanë në mënyrë të barabartë 6 kredite të zbërthyer në 45 orë leksionesh dhe 240 orë studimi jashtë auditorit. Një problem i programeve të lëndës në përgjithësi është literatura mbi të cilën mbështeten; përveçse e limituar në burimet në gjuhë të huaj, në lëndët themelore të programit, literatura në gjuhën angleze mungon për arsyet objektive të moszhvillimit të teksteve universitare në gjuhën angleze.

Programi është i organizuar në lëndë e module mbi bazën e krediteve, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Ndarja e krediteve sipas viteve ndjek organizimin me 60 kredite në vit. Modeli i programit është i diskutueshëm në drejtim të qasjes së tij ndaj edukimit ligjor. Viti i parë i studimit është i përbashkët për të gjitha programet e studimit të lartë që ofron Institucioni pa lidhje me fushën e studimit përkatës. Pra 60 kredite të vitit të parë studentët e programit i marrin në lëndë të tilla si Algjebra, Kompozicioni, etj. Ky model është i aplikuueshëm në qasje interdisiplinore programesh, që nuk përfaqëson natyrën e programit të studimit në fjalë i cili ka objektiva të qarta drejt përgatitjes themelore në fushën e drejtësisë dhe më tej në nivelin master brenda cilit të integruar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi është organizuar sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741 të 2007, sipas vendimit Nr. 939 të datës 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave dhe është akredituar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit e Shkencës Nr. 341 datë 28.08.2013, bazuar në vendimin Nr. 341 datë 28.08.2013 të Këshillit të Akreditimit. Objektivat lidhen me arritjen e kualifikimit të nevojshëm në fushën e drejtësisë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës duke ofruar edukim ligjor në diplomë të nivelit të dytë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

* Programi është i organizuar në 300 kredite në një shtrirje 5 vjecare.

* 1 (një) vit akademik ka - 28 javë mësimore në auditor;

* 1 (një) semestër ka - 13 javë në auditor; 2 javë janë provime mid term dhe provimi përfundimtar;

* 1 (një) ECTS ka - 25 orë mësimore pune të studentit

* 1 (një) orë mësimore - 60 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 13 e Aneksëve)

Në lidhje me planin mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, ngarkesa e lëndëve në planin mësimor është e përcaktuar në bazë të numrit të krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor. Sipas planprogramit, të gjitha lëndët e programit përmbajnë 6 kredite, të zbërthyer në 39 orë mësimore leksion në auditor, të cilave u shtohen 6 orë provime të mid term dhe përfundimtar për të mbërritur në numrin 45 të orëve në auditor. Nuk ka forma të tjera të mësimdhënies përveç leksionit (lënda e dijeve kompjuterike përfshin edhe laborator). Ndërkohë pjesa tjetër prej 105 orësh vlerësohet si punë studimore e studentit. Në fund të programit tema e disertacionit bashkë me kreditet përlllogaritet me 16 kredite, pa ndarje të qartë të krediteve të praktikës nga ato të disertacionit. Mungon dallimi leksione seminare në përndjekje të modelit të edukimit të lartë në sistemet e traditës common law. Në ngarkesën e lëndës janë përfshirë edhe orët e provimeve në 2 javë të programit 15 javor. Kreditet e disertacionit janë më të ulëta sesa kreditet e kërkuara nga Udhëzimi Nr. 15, datë 4.4.2008 "Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" dhe Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Sipas të dhënave të dorëzuara nga ana e Institucionit ngarkesa e programit në bazë të krediteve përfshin elementët më poshtë: leksione 1742, seminare dhe ushtrime 0, laboratore 13, praktikë 100 orë, përgatitje teze 350 orë dhe provime 282 orë. Është e paqartë baza për përlllogaritjen e orëve të përgatitjes së tezave dhe provimeve në

ngarkesën e elementëve të krediteve të lëndës. Gjithashtu, sipas shpjegimeve në Institucion, lëndët zhvillohen njëra pas tjetrës në intensitetin 3 orë në javë për 5 lëndë në javë, duke çuar ngarkesën në javë në auditor në 15 orë. Referuar planprogramit, rezulton se zbërthimi i kreditit është në masën 6.5 orë në auditor dhe pjesa tjetër orë jashtë auditorit, 105 orë studimi për studentët, që të mbledhura me orët në auditor e çojnë në 24 orë zbërthimin e krediti për lëndët me 6 kredite.

Sipas të dhënave të marra në Institucion dhe nga studentët, lëndët me 6 kredite zhvillohen me 3 orë në javë për një frekuencë prej 5 lëndësh në javë që e çon numrin e orëve në javë në 15 orë në javë; rrjedhimisht 39 orë në auditor plotësohen në 13 javë, ndërkohë 2 javët e mbetura lidhen me provimet mid term dhe atë përfundimtar. Ngarkesa total në auditor e vitit akademik rezulton e shtrirë në 26 javë. (Tabela 16 e Anekseve)


Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës dhe vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë, ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara. (Tabela 14 dhe 15 e Anekseve)

Në drejtim të përmbajtjes programi ka tipare që mund të influencojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë jo ezauruese. Kështu, viti i parë i studimit përfshin lëndë të cilat nuk lidhen me fushën e drejtësisë si algjebra, kompozimi dhe arti, *Photography* apo *Contemporary Health Problems*, etj. Megjithë vlerën e pranueshme të ofrimit të disiplinave të tjera që zhvillojnë logjikën dhe hobe të studentëve, dedikimi i 60 krediteve nga 300 kredite të programit jo në lëndë të fushës së drejtësisë është i përshtatshëm në programe interdisiplinore, por nuk përputhet me natyrën dhe objektivat e programit të studimit brenda ciklit të integruar në drejtësi. Në këtë mënyrë nuk i qëndron as klasifikimit të lëndëve në kategori dhe përqindje sipas Udhëzimit Nr. 15, datë 04.04.2008 "*Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë*" dhe Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*". Kjo duket edhe në mungesën në program të lëndëve klasike të programeve të drejtësisë si kriminallogji/penalogji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj.

Syllabuset e lëndëve kanë një format jo uniform; në një përmbledhje, kanë të përbashkët elementë të tillë si emërtimi i lëndës, viti e semestri i realizimit, emri i pedagogut/grupin e pedagogëve, njohuritë që i jep studentit, temat e programit, si edhe numrin e ECTS të lëndës. Ka syllabuse që përmbajnë ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit pa informacion në komponentë të tjerë të detyrimeve të studentëve apo karakterin e detyrueshëm apo më zgjedhje të lëndës. Gjithashtu jo të gjithë syllabuset përmbajnë një listë të detajuar të temave për çdo leksion në auditor apo dhe listën e detajuar të literaturës së detyruar (shih p.sh *Advance Legal Writing and Reasoning, Albanian Business and Labour Law Course, Civil Procedure, Fiscal Law, Law of Obligations, Law Politics and Religion, Legal Environment of Business, Prisons and Penalties*). Sipas të dhënave në Institucion duke nisur nga viti akademik 2018-2019 syllabuset do të jenë në të njëjtin format, një praktikë që do të ndiqet në të gjitha programet.

Në lidhje me ndryshimin e programit në vite, rezulton një paqëndrueshmëri në vitet e fundit në lëndë të rëndësishme; kështu në vitin akademik 2017-2018 mungon lënda *Criminal Procedure* e cila është në vitet e tjera, ndërkohë në vitin akademik 2018-2019 mungon lënda *Administrative Procedure* e cila gjithashtu është në vitet e tjera akademike. Ka ndryshime në vite edhe në lidhje me dy lëndë me zgjedhje *Ethics of Law* e cila nuk ka qenë në programin e vitit akademik 2013-2014, por që është shtuar në vitet në vijim; ndërkohë që lënda *Tort Law* ka qenë në vitin akademik 2013-2014 por është hequr në vitet akademike në vijim. Po kështu në dy vitet e fundit akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 ka pasur ndryshim në lëndët interdisiplinore të vitit të parë, duke zëvendësuar lëndën e *Photography* me *Art History* në vitin akademik 2018-2019. Këto ndryshime të programit janë në përqindje të ulët në raport me numrin total (12-18 kredite në raport me 300 kredite) të krediteve të programit, sidoqoftë ndryshimi në disa raste është në lëndë të rëndësishme. Në përgjithësi nuk është e qartë si përcaktohet angazhimi i një ekipi në një lëndë, nëse ka një vendimmarrje formale për ekipin vlerësues të provimit të një lënde, etj.

Një problem i ndjeshëm i programeve të lëndës në përgjithësi është literatura mbi të cilën mbështeten; përveçse e limituar në burimet në gjuhë të huaj, në lëndët themelore të programit, literatura në gjuhën angleze mungon për arsyet objektive të moszhvillimit të teksteve universitare në gjuhën angleze. Kështu, në lëndë themelore të programit si e drejta civile, e drejta e procedurës civile, e drejta penale, e drejta e procedurës penale, e drejta administrative, e drejta familjare, etj., tekstet shkencore janë në gjuhën shqipe dhe përmbushja e objektivave të lëndëve nuk mund të arrihet nëpërmjet një përmbledhjeje të informacioneve të sistemeve të tjera në gjuhë angleze. Për shembull, në lëndet *Criminal Law I* dhe *Criminal Law II*, literatura, me të drejtë, është tërësisht e bazuar në komentat në gjuhën shqipe si dhe vendime të gjyqësorit shqiptar.



Edhe në lëndët të cilat mbështeten në burime të huaja të tilla si: Theory of Dispute Resolution and Mediation Law, Business law, Legal Environment of Business, Foreign Investments, etj, lidhja e burimeve me qëllimet e kursit është e largët duke mundësuar konsultimin e një literature por jo zbërthimin e objektit kryesor të fushës së studimit në sistemin vendas.

Një tjetër çështje e rëndësishme është mbivendosja e temave në lëndë të ndryshme e cila sjell përsëritje në njohuri që duhet evituar. P.sh ky fenomen vihet re në lëndët *Comparative Public and Constitutional Law, Foundations of Public Law, Constitutional Law and Legislative Process and Techniques* të cilat trajtojnë tema të ngjashme si ndarja e pushteteve, natyra e kushtetutave, pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Disa lëndë të tjera mund të përmirësohen duke u ndjekur kriteri i koherencës midis temave të trajtuara: p.sh *Ethics of Law*, në gjendjen aktuale, është një përzierje midis filozofisë të së drejtës ose teorive të ndryshme të së drejtës (common law, civil law, public law, private law, constitutional interpretation, interpretation of law) dhe çështjeve etike të së drejtës si bioetika, autonomia, eutanazia etj. Një tjetër shembull vjen nga lënda *Domestic and International Human Rights*: kjo lëndë fillon më një hyrje në të drejtat e njeriut dhe në javën e dytë vazhdon me tre gjeneratat e të drejtave të njeriut, për të vazhduar në javën e pestë me temën e të drejtave të njeriut në shekullin e 20-të. Gjithashtu, kjo lëndë trajton në mënyrë të theksuar të drejtat e njeriut nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare humanitare si dhe ka 3 sesione (nga 14 në total) mbi të drejtat e minoritetit, ndërkohë që nuk zbërthen nëpërmjet debatit akademik dhe jurisprudencës, të drejta konkrete nga pikëpamja substanciale si p.sh e drejta e jetës, mbrojtja nga tortura, e drejta e shprehjes, e drejta e jetës private etj. Gjithashtu, sipas syllabusit, në një sesion trajtohen jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, gjë që krijon mbingarkesë dhe rrezikon e një trajtuese sipërfaqësore. Vend për përmirësim mund të ketë dhe në lëndën *Advance Legal Writing and Reasoning* ku p.sh sipas syllabusit 2 sesione i kushtohen intervistimit dhe këshillimit ligjor dhe ku objektivat e këtyre sesioneve përmenden në mënyrë të përgjithshme (p.sh "Students will actively practice this skill in class by interviewing one another and actively learning the principal skills of listening, questioning, analysing and explaining. This class will prepare students for their interviewing and advising assessment") por pa iu referuar ndonjë metodologjie shkencore për t'u përdorur në këto raste.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Universiteti i New York-ut në Tiranë, është hapur me anë të vendimit Nr. 397, datë 15.08.2002 të Këshillit të Ministrave si Shkollë e lartë Universitare dhe është transformuar në Universitet me VKM Nr. 448, datë 11.07.2012. Programi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në drejtësi, është organizuar sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 9741 të 2007, sipas vendimit Nr. 939 të datës 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave dhe është akredituar me vendimin nr. 341 datë 28.08.2013. Programi është i organizuar në lëndë e module mbi bazën e krediteve, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Ndarja e krediteve sipas viteve ndjek organizimin me 60 kredite në vit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programi i Integruar Master Shkencor në Drejtësi synon përgatitjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e drejtësisë, në gjuhën angleze, duke synuar ofrimin e përgatitjes në dy familjet ligjore, atë të të drejtës common law dhe romano-gjermanike me njohuritë në sistemin shqiptar.</p> <p>Arritja e qëllimeve vështirësohet nga mangësitë e evidentuara më lart në drejtim të ngarkesës së ulët, përmbajtjen e programit, literaturën e munguar në gjuhën angleze, etj.</p>

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Përbajtja e objektivave të programit të integruar Master Shkencor në Drejtësi është dhënë në një dokument rregullor të programit, i cili gjithashtu si dokumentat e tjerë nuk ka veshje zyrtare në drejtim të datës së miratimit, organit miratues, etj. Në vlerësim të përgjithshëm mund të thuhet se përbajtja dhe renditja e objektivave synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato.

Sidoqoftë problematikat e implementimit të observuara më sipër mbeten për vlerësim, në drejtim të përgatitjes reale që realizohet nëpërmjet programit në numrin e orëve të lëndëve, literaturës së munguar në gjuhën angleze, saktësia e syllabuseve në drejtim të objektit të studimit dhe temave që trajtohen, lidhja me programin e studimit, etj.

Në drejtim të vlerësimit të studentëve, vlerësimi përfshin vlerësim gjatë vitit, në mid term dhe në provimin përfundimtar.

Përgjithësisht vlerësimi përmban ndarjen 40% detyrë kursi dhe 60% provim përfundimtar. Mbetet përsëri e paqartë në bazë të rregulloreve të shkruara se si ngrihet komisioni i vlerësimit përfundimtar në një lëndë; nuk ka një procedurë formale të përcaktimit të një komisioni vlerësues në lëndë apo të një organizimi të qartë fazash provimesh.

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvijën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara</p>	<p>Programi ka tipare që lidhen me studimin e të drejtës ndërkombëtare dhe atë të BE-së, për të cilat dhe literatura në gjuhë të huaj është e përshtatshme dhe mund të shërbejë për zhvillimin e tyre.</p> <p>Bashkëpunimi për disa vite me Universitetin e Greenwich mund të konsiderohet si eksperiencë e vlefshme në drejtim të mbështetjes në praktika të mira. Sidoqoftë që të arrihet konkurrueshmëria dhe të përmbushen standardet europiane të programeve të drejtësisë është e nevojshme të adresohen më përshtatshëm çështjet e evidentuara më sipër.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Mund të thuhet se përgjithësisht programi i integruar Master Shkencor është i lidhur me profilin e Institucionit si Universitet në fushën e arsimit të lartë dhe objektivat në fushën e edukimit ligjor.</p> <p>Sidoqoftë siç është theksuar edhe më sipër kurrikula e programit ka tipare që mund të influencojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë jo ezauruese. Megjithë vlerën e pranueshme të ofrimit të lëndëve që zhvillojnë logjikën dhe hobe të studentëve, dedikimi i 60 krediteve nga 300 kredite të programit jo në lëndë të fushës së drejtësisë është i përshtatshëm në programe interdisiplinore, por nuk përputhet me natyrën dhe objektivat e programit të studimit brenda ciklit të integruar në drejtësi. Në këtë mënyrë nuk i qëndron as klasifikimit të lëndëve në kategori dhe përqindje sipas Udhëzimit Nr. 15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” dhe Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Kjo duket edhe në mungesën në program të lëndëve klasike të programeve të drejtësisë si kriminalogji/penalogji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj. Lëndët kanë të njëjtin numër kreditesh, 6 kredite, pa dalluar midis tyre nga pesha.</p> <p>Sipas konsultimit në takime dhe informacionit në dokumentacion, personeli akademik angazhohet aktivisht në punë kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve, për të ofruar nivelin më cilësor e të fundit në fushën përkatëse; spikasin aktivitetet në kuadër të Qendrës Kërkimore.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	

Daniela Ripari

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Institucioni ka një dokument në lidhje me mënyrën e studimit të tregut të punës për qëllime të përshtatshmërisë së programit me këto nevoja por nuk rezulton të ketë një studim të posaçëm shkencor tregu të punës për këtë program.</p> <p>Për qëllime të vlerësimit të nevojave të tregut dhe përgjigjes ndaj tij, nga ana e Institucionit vlerësohet praktika e përvitshme e Panaireve të Punës, marrëveshjet e realizuara me subjekte të ndryshme të tregut të punës, Memorandumet e Bashkëpunimit me Dhoma të Tregëtisë etj.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Mund të thuhet se Programi i Integruar Master Shkencor në Drejtësi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Me përmirësim të standardeve sipas observimeve më sipër do të ndihmohej me shumë zhvillimi i vlerave kulturore kombëtare që lidhen edhe me përgatitjen në edukimin në të drejtën kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Programi i integruar Master Shkencor ne Drejtësi përfundon me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Programi realizohet me 300 kredite europiane ECTS në 5 vite akademike, por duke lidhur përfitimin e 60 krediteve në lëndë jo të fushës së drejtësisë.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Në konsultim me studentët e programit dhe me informacionin e dorëzuar nga Institucioni mund të thuhet se studentëve u ofrohet informacion i konsultueshëm që përfshin mënyrën e organizimit të institucionit, programet që ofrohen, modulet dhe syllabuset, etj</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	

Donaldis Pipari

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Rregullorja e programit megjithëse jo në formatin e një rregulloreje formale me nene dhe rregullime ezuaruese ka informacion mbi organizimin e programit, lëndët, detyrimet e studentit, kërkesat për përmbushjen e kërkesave të programit të integruar, mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve etj.

Për realizimin e projektit kërkimor dhe tezës janë parashikuar 18 kredite, pjesë e të cilave është edhe praktika në institucione. Është e paqartë si dallohen kreditet përkatëse, në çdo rast janë më pak se 30 kredite.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i integruar Master Shkencor ne Drejtësi përfundon me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Programi realizohet me 300 kredite europiane ECTS në 5 vite akademike, por duke lidhur përfitimin e 60 krediteve në lëndë jo të fushës së drejtësisë.
2. Programi ka tipare që lidhen me studimin e të drejtës ndërkombëtare dhe atë të BE-së. Arritja e objektivave të programit vështirësohet nga mangësitë në drejtim të qasjes interdisiplinore me vitin e parë të bazuar në lëndë të fushës së artit, kulturës dhe shkencave natyrore jashtë fushës së drejtësisë, ngarkesës së ulët të orëve në auditor, kurrikulën e kufizuar, literaturën e munguar në gjuhën angleze.
3. Ka disa rregullime për mënyrën e studimit të tregut të punës por nuk rezultojnë të ketë një studim të posaçëm shkencor tregu të punës për këtë program apo në përgjithësi. Në përgjithësi aktet e programit nuk kanë veshje formale, referenca në vendime strukturash, etj.
4. Për realizimin e projektit kërkimor dhe tezës janë parashikuar 18 kredite, pjesë e të cilave është edhe praktika në institucione. Është e paqartë si dallohen kreditet përkatëse; në çdo rast janë më pak se 30 kredite.
5. Syllabuset e lëndëve duhen rishikuar në mënyrë që të respektohet një format, studentët të marrin informacion të detajuar lidhur me çështjet themelore dhe literaturën përkatëse, të evitohen mbivendosjet, si dhe të sigurohet një koherencë e brendshme.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Sipas RVB dhe të dhënave të Institucionit, programi i studimit organizohet në lëndë të formimit të përgjithshëm ku përfshihen lëndë jo të fushës së drejtës si algjebra, historia botërore, statistika etj. Më pas programi përmban lëndë të detyrueshmë të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me degët e së drejtës dhe përbëjnë thelbin e formimit në drejtësi. Programi ofron dhe lëndë më zgjedhje si dhe një temë diplome si detyrim përmbyllës.

Pra, programi bazohet në vitin e parë në lëndë të formimit të përgjithshëm të cilat kanë për qëllim formimin e përgjithshëm të studentëve si dhe përgatitjen e tyre për tranzicionin nga shkolla e mesme në lëndët karakterizuese të programit. Ky program bazohet në modelin *Liberal Arts and Sciences* i cili në mënyrë të ngjashme bazohet në formimin e përgjithshëm në vitin e parë të studimeve, dhe në profilizimin e studentëve në një *major* të caktuar në vitet pasardhëse. Sidoqoftë, në programin në fjalë profilizimi është i paracaktuar, në drejtësi, dhe nuk ka hapësira për zgjedhje të *major* të tjerë. Për pasojë, edhe pse disa nga lëndët e formimit të përgjithshëm mund të jenë të vlefshme për studimet juridike, mund të mendohet që disa nga keto lëndë të hiqen nga programi ose të përmbledhen në semestrin e parë të vitit të parë me qëllim që semestri i dytë të ofrojë lëndë bazike të së drejtës, si psh e drejta romake e cila në modelin aktual ofrohet si lëndë më zgjedhje, ndërkohë që dihet që kjo lëndë përbën bazën e sistemeve të civil law.

Sipas RVB (fq. 82), programi i studimit "*UNYT integron leksione, seminare, praktikë dhe workshope*"; Kjo formë interaktive e mësimdhënies u konfirmua dhe nga biseda me studentët e programit.

Lidhur me mësimdhënien dhe cilësinë e saj përmendim:

1. Siç është përmendur dhë më lart (Struktura e Fakultetit dhe Departamentit) rezultojnë se në disa lëndë, lektorët përgjegjës janë staf me gradën "Doktor" ose titullin "Prof. Asoc" dhe "Prof", në lëndë të tjera ka

një kombinim të lektorëve përgjegjes doktorant dhe atyre me grada dhe tituj, ndërsa në disa lëndë të tjera lektorët përgjegjës kanë titullin "LLM" ose master shkencor. Kjo praktikë e konstatuar nuk është në përputhje të plotë me nenin 59(6) të Ligjit për Arsimin e Lartë i cili parashikon që "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës." Kjo çështje është trajtuar edhe në Rubrikën 3 "Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit".

2. Gjithashtu vihet re ngarkesë e madhe e pedagogëve të caktuar të cilët japin disa lëndë gjatë një viti akademik. Edhe pse klasat janë përgjithësisht të vogla - dhe për pasojë ngarkesa mund të jetë më e vogël krahasuar me programe më të mëdha - ngarkesa e pedagogëve përfshin dhe përgatitjen e materialeve në anglisht ose përkthimin e legjislacionit duke qenë se i gjithë programi - me përjashtim të Historisë së Shtetit Shqiptar - është në anglisht.
- P.sh në vitin akademik 2018-2019, pedagogu D.V është i përfshirë (si lektor kryesor ose bashkë lektor) në jo më pak se 9 lëndë të cilat përfshijnë lëndë të ndryshme të së drejtës si Roman Law, Civil Law, Comparative Public and Constitutional Law, Family Law, Intellectual Property, Refugee Law, Private International Law etj. Kjo praktikë ngre pikëpyetje lidhur me nivelin e informacionit të specializuar që studentët marrin në këto lëndë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Shih Tabelën 16)

Siç shihet dhe në Tabelën 16, format e mësimdhënies për këtë program studimi janë: leksione/seminare, laboratore, praktike profesionale, përgatitje për tezën si dhe provime. Siç u konfirmua dhe nga takimi me stafin dhe studentët, programi i studimit nuk ben dallim midis leksioneve dhe seminareve; mësimdhënia është interaktive.

- Format e kontrollit të njohurive (Shih Tabelën 17)

Format e kontrollit të njohurive varen nga lloji i lëndës, megjithatë parimi kryesor është ai i disa komponentëve në vlerësim të cilët janë: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve (detyrat e kursit), testimet gjatë vitit, provimi përfundimtar. Nga një shqyrtimi i silabuseve rezulton se ky format përgjithësisht respektohet me disa përjashtime. P.sh lënda Advance Legal Writing and Reasoning, për vetë natyrën e saj, nuk ka provim final. *Banking and Financial Law* si dhe *Domestic and International Bankruptcy Law* përmbajnë vetëm një testim gjatë vitit dhe një provim përfundimtar. Silabusi i lëndës *Civil Procedures* përcakton format e kontrollit të njohurive por nuk përcakton përqindjet.


- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (Shih Tabelën 18)

Sipas informacioneve të dhëna nga institucioni, 25 studentë janë përfshirë në punimet shkencore individuale të pedagogëve; 78 në projekte shkencore në rang departamenti; 78 në projekte shkencore në rang Fakulteti dhe 1 student në projekte në bashkëpunim me të tjerë, lektorëve; 5 studentë në projektet shkencore në nivel departamenti; dhe 7 studentë në projekte shkencore në nivel fakulteti. GVJ nuk disponon të dhëna konkrete të këtyre përfshirjeve, por ky fakt u konfirmua dhe nga biseda me stafin akademik të cilët pohuan se studentët përfshihen në kërkimin shkencor të Departamentit kur p.sh tema e diplomës lidhet me fushën kërkimore të pedagogut. Përfshirja e studentëve në projekte u konfirmua dhe gjatë bisedës me studentët në Institutin: u përmend përfshirja e tyre në workshopet mbi të drejtën e refugjatit në të cilat studentët u angazhuan në kërkim shkencor dhe përgatitjen nga një *paper* secili që më pas u prezantua. Gjithashtu një tjetër projekt ku studentët kanë marrë pjesë është "Divorce cases under the Ottoman Empire". Një shembull tjetër ishte projekti mbi të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me Ambasadën Hollandeze, ku studentët u angazhuan në kërkim shkencor dhe shpërndarjen e informacionit në shkollat e Shqipërisë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe



problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në bazë të nenit 76 të Ligjit për Arsimin e Lartë, "pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë". Nga vizita në sekretarinë mësimore rezultoi se dosjet e aplikimit të studentëve përmbajnë: formularin e aplikimit; diploma e shkolles së mesme ose njohje e diplomës nga MAS; listë notash; dokument identifikimi; letër rekomandimi; dëshmi e gjuhës angleze (niveli B1) formulari i kodit të ndershmërisë akademike, advisory form (për lëndët e cdo semestri që studenti ka ndjekur)

Në strukturën organizative të Institucionit përfshihet dhe Zyra e Karrierës dhe e marrëdhënieve me të diplomuarit si dhe studentët përfaqësohen në Këshillin Studentor. Zyra e Karrierës parashikohet në nenin 55 të Statutit të IAL. Zyra e karrierës është përgjegjëse për marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe studentëve. Sipas drejtuesit të zyrës së Karrierës, njoftimet për vende pune publikohen përgjithësisht online. Ai gjithashtu përmend dhe nënshkrimin e marrëveshjes me Dhomën Turke të Tregtisë që pritet të bëjë të mundur që kompani turke të marrin studentë për praktikë/punësim. Institucioni nuk duket të bazohet në një studim të tregut, por Zyra e Karrierës ndjek trendin e studentëve gjatë ciklit të studimit dhe pas diplomimit. Përgjithësisht studentët vazhdojnë studimet jashtë (Mbretëri e Bashkuar, Hollandë) ose punojnë në sektorin privat. Një herë në vit në Institucion organizohet panairi i punës. Alumni mbledhen një herë në 2 ose 3 vjet. Zyra e Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me ta. Sipas drejtuesit të Zyrës së Karrierës, numri relativisht i vogël i studentëve mund të shpjegohet nga fakti që programi është në gjuhën angleze, tnga tarifa dhe nga emri/reputacioni i fortë i institucionit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:


Procedurat e pranimit të studentëve

RVB (fq. 84) liston këto kriteret për pranimin e studentëve: formularin e aplikimit, diplomën e maturës shtetërore dhe listë notash, 4 foto, një deklaratë nga aplikanti, dëshmi e gjuhës angleze (niveli B1) nota mesatare minimalisht 6,5. Gjithashtu Rregullorja e Programit të Studimit (e miratuar në Dhjetor 2018) në pikën 3.2. përcakton diplomën e maturës shtetërore (ose ekuivalente të saj), mesatare të notave 6, një intervistë si dhe dëshminë e gjuhës angleze, si kriteret për pranim në program. Gjithashtu, Senati Akademik i Institucionit me vendimin nr. 43, dt. 30.03.2018, ka përcaktuar kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2019-2020 të cilat janë niveli B1 i gjuhës angleze dhe mesatarja e notave 6,5.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Shih Tabelën 19.1 dhe 19.2)

Bazuar në RVB si dhe, sipas informacionit të shqyrtuar nga GVJ në sekretarinë mësimore, rezultojnë këto të dhëna:

- Për vitin akademik 2013-2014, janë 9 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8.2 dhe 1 student i transferuar në vitin e tretë. Në total 10 studentë.
- Për vitin akademik 2014-2015, janë 12 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8.4 dhe 3 studentë të transferuar në vitin e parë dhe të dytë. Në total 15 studentë. Sipas të dhënave në sekretarinë mësimore, në këtë vit janë 12 studentë të regjistruar për herë të parë, 3 të transferuar, 4 studentë të reregjistruar.
- Për vitin akademik 2015-2016, janë 16 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8.4. Sipas të dhënave në sekretarinë mësimore, në këtë vit janë 16 studentë të regjistruar për herë të parë, 1 i transferuar, 1 student i reregjistruar.
- Për vitin akademik 2016-2017, janë 13 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8.3. Sipas të dhënave në sekretarinë mësimore, në këtë vit janë 13 studentë të regjistruar për herë të parë, 2 studentë të reregjistruar.
- Për vitin akademik 2017-2018, janë 12 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8 dhe 1 student i transferuar në vitin e dytë. Në total 13 studentë. Sipas të dhënave në sekretarinë mësimore, në këtë vit janë 13 studentë të regjistruar për herë të parë, 2 të transferuar, 2 studentë të reregjistruar.



- Për vitin akademik 2018-2019, janë 13 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 8.2 dhe 4 studentë të transferuar në vitin e parë dhe të dytë. Në total 17 studentë. Sipas të dhënave në sekretarinë mësimore, në këtë vit janë 20 studentë të regjistruar për herë të parë, 4 të transferuar dhe 2 studentë të cilët kanë ndryshuar degë.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). (Shih Tabelën 20)

Për vitin 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 5 studentë.

Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela 20)

- Për vitin akademik 2013-2014: 9 të diplomuar; 8 në përputhje me diplomën; 1 i punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2014-2015: 7 të diplomuar; 7 në përputhje me diplomën; 0 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2015-2016: 14 të diplomuar; 12 në përputhje me diplomën; 2 të punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2016-2017: 11 të diplomuar; 10 në përputhje me diplomën; 1 i punësuar jo në përputhje me diplomën;
- Për vitin akademik 2017-2018: 5 të diplomuar; 4 në përputhje me diplomën; 1 i punësuar jo në përputhje me diplomën.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Marrëveshja me Dhomën Turke të Tregtisë
- Model vlerësimi për praktikën

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me nenet 74 dhe 76 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH".</p> <p>Studentët që pranojnë në këtë program studimi kanë mbaruar matëruën shtetërore dhe që plotësojnë kriterin e mesatares. Kriteri i gjuhës angleze (por edhe i gjuhëve të tjera të përcaktuara në ligj), është një kriter hyrës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë e Institucionit, të dhënat janë të plota dhe studentët plotësojnë kriteret hyrëse.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	

[Signature]

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Karrierës e cila është përgjegjëse për lidhjen midis studentëve dhe punëdhënësve potencialë. Në përmbushje të detyrave të saj, Zyra e Karrierës informon studentët për mundësitë e punësimit si dhe për praktikatat.</p> <p>Studentëve u jepet informacion për institucionin dhe për programet e studimit që ofrohen, si edhe kanë këshillim karriere.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të plota në lidhje me studentët e regjistruar në program, ecurinë e tyre, tërheqjen apo transferimin. Ky informacion u mor në sekretarinë mësimore të IAL në prani të sekretares.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve, duke bërë dallimin midis punësimit në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me diplomën.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të rregullt për programin e studimit, organizimin e tij. Nga bisedat me studentët u konfirmua ky fakt dhe u konstatua se midis studentëve dhe administratës/stafit akademik mbahen kontakte të afërta. Ky fakt lehtësohet sidomos nga numri i vogël i studentëve në këtë program.</p> <p>Studentët informohen për vlerësimin e tyre. Neni 70 i Statutit të IAL parashikon se studentët mund të përdorin procedurat e ankimimit të vlerësimeve. Ekziston një formular për një peticion/ankimim formal, dy shembuj të të cilëve u panë në sekretarinë mësimore.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p>	<p>IAL ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Praktika profesionale parashikohet si pjesë e detyrueshme e këtij programi studimi. Ajo përbën 100 orë të programit të studimit ose 36 kredite. Praktikrat realizohen përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit që Institucioni ka. Së fundmi Institucioni ka lidhur një marrëveshje me Dhomën Turke të Tregtisë. Në përfundim të praktikës përfaqësuesi i punëdhënësit plotëson një formular të vlerësimit të studentit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. Studentët që aplikojnë dhe pranohen në këtë program studimi kanë përfunduar maturën shtetërore. 2. IAL informon studentët lidhur me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. 3. IAL mban të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi. 4. IAL disponon të dhëna lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar. 5. IAL ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin. 	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

“Strategjia e Kërkimit Shkencor të IAL 2014-2017” dhe “Shtyllat Kryesore të Kërkimit për Qendrat dhe Departamentet në IAL (2018-2022)”, përbëjnë bazën e kërkimit shkencor në institucion dhe të programit të studimit në fjalë. Strategjia e Kërkimit për 2014-2017 përcakton këto objektiva strategjike për kërkimin shkencor: rritje sasiore e kërkimit shkencor, rritje e kërkimit interdisiplinor në bashkëpunim dhe me institucione të tjera kërkimore, rritje e ndikimit të kërkimit dhe rezultateve në rajon dhe më gjerë si dhe mësimdhënie e bazuar në kërkim shkencor. Kjo strategji përcakton dhe metodat e matjes së produktit shkencor duke përfshirë: numri i granteve kërkimore, numri i monografive të botuara, numri i artikujve në revistat akademike me faktor impakti etj. Strategjia e Kërkimit Shkencor 2014-2017 përcakton objektivat kryesore të kërkimit dhe metodat/procedurat për përmbushjen e tyre, por nuk përmban një program kërkimi shkencor i cili reflekton fushat e kërkimit shkencor të stafit. Pra, më shumë se shtyllat kryesore të kërkimit sipas fushave/disiplinave përkatëse, Strategjia përcakton procedurat dhe metodën për matjen e produktit të kërkimit shkencor.

Shtyllat Kryesore të Kërkimit Shkencor (2018-2022) është një dokument i organizuar në bazë Fakulteti dhe përcakton kollonat kryesore të kërkimit. Për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale shtyllat kryesore të kërkimit shkencor janë: 1) Demokracia dhe ndyshimet social-kulturore; 2) Integrimi European; 3) Globalizimi dhe politikat gjeopolitike. Stafit akademik i programit të studimit në fjalë nuk rezulton të jetë i përfshirë në shtyllat e kërkimit shkencor me projekte specifike.

Siç është përmendur dhe më lart, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka në përberje një Qendër Kërkimore me 7 anëtarë. Qendra ka për qëllim të koordinojë të gjitha projektet kërkimore. Aktiviteti i saj bazohet në shtyllat e kërkimit të cilat janë rinovuar në vitin 2018. Qendra harton objektivat vjetore, përgatit një raport vjetor monitorimi. Këto plotësohen nga objektivat individuale për çdo anëtar të stafit akademik si dhe raporti i vlerësimit vjetor. Gjatë takimit më përfaqësuesit nga Zyra e Projekteve dhe Inovacionit, GVJ u informua mbi

idenë e krijimit të një research centre në nivel institucioni duke qenë se dhe projektet janë gjithmonë e më shumë me karakter multidisiplinor. Gjithashtu në këtë takim u përmend dhe fakti që financimet për projekte të kërkimit shkencor vijnë jo vetëm nga jashtë (p.sh Erasmus +) por dhe nga Institucioni. Në institucion u kërkua dokumenti që pasqyron fondin prej 25000 Eur të dhënë nga institucioni dhe se si është ndarë. Ky dokument evidenton që për vitin 2017-2018 nga institucioni janë dhënë 25000 Euro, nga të cilët 5000 për projekte kërkimi shkencor, 10000 për pjesëmarrje në konferenca, 5000 për publikime akademike, 5000 për organizimë konferencash. Megjithatë, informacioni mbetet i vakët pasi nuk është e qartë cilët projekte konkrete apo anëtarë të stafit akademik kanë përfituar nga këto fonde.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Për më shumë shih Tabelën 21).

Tabela 21 pasqyron aktivitetet e planifikuara në nivel individual dhe në rang programi studimi në vitet e fundit (nga lista e publikimeve kuptohet që behet fjalë për periudhën 2013-2018). Sipas këtyre të dhënave PAE i IAL ka 15 botime. Nga 9 projekte të fituara, 8 janë zbatuar. Institucioni ka zhvilluar 3 aktivitete shkencore për programin e studimit. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi dokumentacion që tregon rezultate konkrete të projekteve kërkimore të zbatuara si psh konferenca të organizuara apo publikime.


Dokumenti "UNYT Externally Funded Projects" jep një pasqyrë të projekteve të fituara dhe zbatuara nga Institucioni. Ndonëse ka pjesëmarrje të Institucionit në disa projekte ndërkombëtare, kjo nuk është gjithmonë dhe domosdoshmërisht e lidhur me programin e studimit në fjalë. Ja dhe disa shembuj:

- Projekti "An Adriatic Network for Advancing Research Development and Innovation towards the Creation of new Policies for Sustainable Competitiveness and Technological Capacity of SME-s" i zbatuar në vitet 2014-2018 nuk duket të jetë drejtpërdrejt i lidhur me programin e studimit në fjalë dhe nuk është e qartë nga dokumentacioni nëse stafi akademik i programit të studimit është pjesë e këtij projekti.
- Projekti "Strategic Support on Strengthening the Quality Assurance Structures at the Private Higher Education Institutions in Albania" i zbatuar në vitet 2015-2018, nuk lidhet drejtpërdrejt me kërkimin shkencor dhe me programin e studimit por më shumë me përmirësimin e funksionimit të Institucionit.
- Projekti "Industrial Citizenship and Migration from the Western Balkans: Migration from Albania and Kosovo towards Greece, Germany and Switzerland" i zbatuar në vitet 2014-2017 ka për qëllim të eksplorojë procesin e fitimit të të drejtave të emigrantëve nga Ballkani Perëndimor drejt Bashkimit Europian, për rrjedhojë një lidhje mund të ekzistojë me programin e studimit.
- Projekti "Rritje e Ndërgjegjësimin dhe e Kulturës Muzeale në Berat" (2014-2015) nuk lidhet drejtpërdrejt me programin e studimit në fjalë.
- Projekti "EU Democracy Promotion" (2016-2019) i financuar nga fondet Erasmus + është një modul Jean Monnet dhe ka për qëllim përgatitjen e dy lëndëve mbi EU Democracy Promotion (një në nivel bachelor dhe një në nivel master). Këto kurse mund të shërbejnë për diversifikimin e mësimdhënies në Institucion, por nuk është plotësisht e qartë nëse i shërbejnë drejtpërdrejt programit të studimit në fjalë.
- Projekti "Refugee Law" (2017-2018) është një projekt i financuar nga fondet Erasmus +. Gjatë bisedës në Institucion doli qartë që ky projekt u ka shërbyer si studentëve, përmes organizimit të workshopeve, ashtu dhe një pjesë të stafit akademik, pasi si rezultat i këtij projekti artikulli nga E.K dhe D.V "Irregular Migration by Sea: Interception and Rescue Intervention in Light of International Law and the EU Sea Borders Regulation" është pranuar për publikim në European Journal of Migration and Law.

Si konkluzion, ndonëse Institucioni që nga akreditimi i mëparshëm është përfshirë në projekte kërkimore, jo të gjitha pjesëmarrjet janë të lidhura më programin e studimit në fjalë dhe jo për të gjitha projektet ka evidencë të pjesëmarrjes së stafit akademik që angazhohet në programin e studimit në fjalë.

Nga shqyrtimi i jetëshkrimeve të personelit akademik (efektiv ose me kontratë) të programit të studimit në fjalë, rezultojnë këto botime akademike:

- A.E: nuk ka publikime ose prezantime;
- A.M: bashkeautor i research paper "European External Borders: Keeping out the "Unwanted" at all Costs" The Third International Young Researchers Conference on Law, Beder University;
- A.Zh: nuk ka prezantime në konferenca ose publikime;
- B.N: pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare si dhe trajnues, 13 publikime në revista ndërkombëtare;
- B.B: pjesëmarrës në seminare të shumtë, 12 publikime në revista komëbtare dhe ndërkombëtare;



- D.V: prezantime të shumta në konferenca ndërkombëtare si dhe publikime të shumta në revista ndërkombëtare, mes tyre dhe prestigjioze, si Liverpool Law Review, Politica del Diritto, Journal of Law and Medicine etj;
- E.D: 3 shkrime, njëri botuar në LinkedIn (pra jo në revista shkencore);
- E.Gj: 12 publikime në fushën e mjekësisë;
- E.K: 3 artikuj dhe 1 kapitull libri, si dhe 3 prezantime në konferenca;
- E.K:3 kapituj në librin "Public International Law" 2013 (të dhënat bibliografike për librin nuk janë të plota); 1 artikull në Academicus International Scientific Journal; 2 artikuj si bashkëautore në revista prestigjioze ndërkombëtare si European Journal of Migration Law dhe Medicina Legal e del Diritto in campo sanitario;
- E.Ç: publikime dhe prezantime të shumta, profil sh i zhvilluar i publikimeve;
- F.T: publikime dhe prezantime të shumta, profil sh i zhvilluar i publikimeve;
- H.R: 2 publikime;
- J.Sh: publikime dhe prezantime të shumta, profil i zhvilluar i publikimeve;
- J.Q: nuk ka publikime apo prezantime;
- J.M: 7 publikime në revista ndërkombëtare si dhe një seri prezantimesh;
- L.B: nuk ka publikime apo prezantime;
- M.K: nuk ka publikime apo prezantime;
- E.O: 4 prezantime në konferenca kombëtare, 5 publikime në revistën juridike të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- UNYT Externally Funded Projects
- Budget research 2016-2017-2018

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Më shumë se gjysma e stafit të angazhuar në programin e studimit në fjalë kanë publikime në revista kombëtare ose ndërkombëtare. Një pjesë e stafit, të cilët gjithsesi janë angazhuar në mësimdhënie në lëndë bazë të programit, nuk ka prezantime ose publikime. Një pjesë e publikimeve janë në revista prestigjioze, një pjesë tjetër në revista më pak të njohura dhe më një vizibilitet më të ulët.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze (me përjashtim të lëndës "Historia e Shtetit Shqiptar") nga staf akademik që kanë kryer studimet në atë gjuhë ose që kanë njohje të avancuar të saj. Gjithashtu, personeli akademik që angazhohet në këtë program ka tashmë përvojë të gjatë në mësimdhënie në këtë gjuhë.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjeshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e	Institucioni angazhohet që stafi akademik të përfitojë nga aktivitetet shkencore të zhvilluara. Gjithashtu nga dokumentacioni por dhe nga vizita në institucion rezulton se një pjesë e vogël e stafit ka përfutur nga kualifikime/periudha kërkimore jashtë shtetit si p.sh A.E ka vizituar Middle East Technical University (METU) në korrik 2018; D.V ka qenë po në METU.

kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	(maj 2017), Caserta, (qershor 2018), Bazel (tetor 2018).
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. Një burim i këtyre të dhënave janë jetëshkrimet e secilit anëtar të stafit akademik. Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, por pa referenca të sakta të pjesëmarrjes së personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Një pjesë e stafit akademik ka publikime në fushën përkatëse kërkimore dhe të mësimdhënies, të cilat janë me vlerë dhe për programin e studimit. Siç është vërejtur dhe më lart, për një pjesë të personelit akademik nuk ka të dhëna lidhur me publikimet apo prezantime në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare. IAL duhet të marrë masa për përmirësimin sasior por dhe cilësor të output-it të kërkimit shkencor. IAL duhet të inkurajojë stafin akademik të botojë në revista prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në fusha që lidhen me programin e studimit në fjalë. 2. Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze nga personel akademik i kualifikuar. 3. IAL i ofron mundësinë e kualifikimeve të vazhdueshme stafit akademik nëpërmjet vizitave kërkimore-shkencore ose periudhave të mësimdhënies në universitete të huaja. 4. IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun



Pjesa përshkrimore

Institucioni bashkëpunon me subjekte publike e private për qëllime të realizimit të praktikave të programit si dhe aktivitete bashkëpunimi. Janë disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë, dhe sipas të dhënave nga Institucioni, ka pjesëmarrje në projekte rajonale e ndërkombëtare që nxiten e mbështeten nga institucioni. Ka raste mobilitetesh të personelit akademik sidomos atyre që janë pjesë e Qendrës Kërkimore por në takime u raportuan edhe raste mobiliteti të studentëve në kuadër të programeve të bashkëpunimit dhe aplikimit në projekte Erasmus.

Në lidhje me marrëveshjet me institucione të arsimit të lartë në rajon dhe Evropë, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet në vijim, SUNY-ESC, University of Greenwich, Bilston Community College (BÇ), Middle East Technical University METU, University of Bolton, Selcuk, University MUS Alparslan University Science Po Rennes, France Univeristy of New York Prague (UNYP) New York College, Athens New York College Thessaloniki, Salzburg University, Politechnica Bucharest University of Genoa, Dicle University, Turkey, Tbilisi State University, Georgia, University of Porto, Portugal, University of A Curuña, Spain etj.

Me Institucionet vendase gjithashtu ka marrëveshje si me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, etj.; me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si edhe me subjekte të tjerë privatë si European Center Publication, Alpha Bank, Dhoma e Tregtisë Turke etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për aktivitete nga bashkëpunimet shkencore (Tabela 22.1 dhe 22.2 e Anekseve)

Sipas të dhënave në RVB aktivitete shkencore në nivel individual dhe institucional në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë pesë viteve të fundit evidentohet si më poshtë:

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare ose ndërkombëtare: 4
 Numri i leksioneve dhe seminareve me ligjërues të huaj: 1
 Numri i pjesëmarrësve në trajnime jashtë vendit në fushën e kërkimit shkencor: 2
 Lëvizja e studentëve drejt dhe nga IAL: 0
 Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor: 1
 Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore dhe prezantime jashtë IAL / jashtë vendit: 5
 Numri i çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor: 0

Nuk ka një zbrëthim të saktë të përfitimeve dhe angazhimeve konkrete në kuadër të marrëveshjeve të lidhura, përveç të dhënave numerike të pjesëmarrjes si më sipër. Me disa subjekte publike e private bashkëpunimi është për qëllime të realizimit të praktikave të programit si dhe aktivitete bashkëpunimi.

Tabela e plotë me Institucionet më të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi gjendet në tabelën 23 të Anekseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
 - Marrëveshje me Dhomën Turke të Tregtisë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Praktika që parashikon programi i interguar Master Shkencor në drejtësi, realizohet bashkë me punën kërkimore të tezës, pa një ndarje të krediteve të nevojshme.</p> <p>Realizimi i praktikës mund të thuhet se mundësohet nga marrëdhëniet e bashkëpunimit me subjekte të ndryshme të nivelit publik dhe privat që mundësojnë përfitimin e njohurive profesionale të përshtatshme.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe konsultimi me dokumentacion dhe diskutime me anëtarë të të gjitha niveleve mund të thuhet se Institucioni ka një organizim bashkëpunues midis niveleve e strukturave të tij. Komunikimi midis stukturave e njëjësive gjithashtu reflekton një frymë pozitive bashkëpunimi midis stafit të niveleve të ndryshme.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>Në lidhje me marrëveshjet me institucione të arsimit të lartë në rajon dhe Evropë, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet në vijim, SUNY-ESC, University of Greenwich, Bilston Community College (BC), Middle East Technical</p>

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

University METU, University of Bolton, Selcuk, University MUS Alparslan University Science Po Rennes, France Unveristy of New York Prague (UNYP) New York College, Athens New York College Thessaloniki, Salzburg University, Politechnica Bucharest University of Genoa, Diele University, Turkey, Tbilisi State University, Georgia, University of Porto, Portugal, University of A Curuña, Spain etj.

Me Institucionet vendase gjithashtu ka marrëveshje si me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, etj.; me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si edhe me subjekte të tjerë privatë si European Center Publication, Alpha Bank, Dhoma e Tregtisë Turke etj. Panairi i punës zhvillohet në çdo vit dhe cilësohet me një interes të gjerë nga ana e studentëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Praktika që parashikon programi i integruar Master Shkencor në Drejtësi, realizohet bashkë me punën kërkimore të tezës, pa një ndarje të krediteve të nevojshme.
2. Mund të thuhet se Institucioni ka një organizim bashkëpunues midis niveleve e strukturave të tij. Komunkimi midis stukturave e njësisve gjithashtu reflekton një frymë pozitive bashkëpunimi midis stafit të niveleve të ndryshme.
3. Institucioni bashkëpunon me subjekte publike e private për qëllime të realizimit të praktikave të programit si dhe aktivitete bashkëpunimi. Ka disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë, dhe sipas të dhënave nga Institucioni, ka pjesëmarrje në projekte rajonale e ndërkombëtare që nxiten e mbështeten nga institucioni.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a. Të rritet kërkimi shkencor në nivel institucional;
- b. Të përmirësohet regjistri i amzës, i cili duhet të jetë me shkrim dore dhe gjithashtu notat duhet të mbahen edhe në regjistër me shkrim dore.

Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a. Për rekomandimin "a", GVJ konstaton që Institucioni, që nga akreditimi i mëparshëm, është përfshirë në disa projekte kërkimore, organizime konferencash e aktivitete shkencore. Institucioni ka arritur të jetë pjesë e disa projekteve kërkimore shkencore si dhe gjithashtu ka mbështetur me fonde të brendshme aktivitetin shkencor. Një pjesë e stafit të angazhuar në programin e studimit në fjalë ka publikime në revista kombëtare ose ndërkombëtare, disa në revista prestigjioze, një pjesë tjetër në revista më pak të njohura dhe me një vizibilitet më të ulët. Mund të thuhet sidoqoftë që përpjekjet e bëra janë të vlerësueshme e për këtë arsye GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet përgjithësisht i plotësuar por në nevojë për t'u zhvilluar e konsoliduar më tej.



- b. Për rekomandimin “b”, GVJ konstaton që regjistri i amzës mbahet me shkrim dore, ndërsa regjistri i notave me shkrim dore ende nuk përdoret nga Institucioni, pasi përdoret ai i digjitalizuar. Sa më lart, **GVJ konkludon se ky rekomandim konsiderohet i plotësuar pjesërisht.**


II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS -PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES -MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)

a. Pika të forta:

1. Programi është realizuar për disa vite akademike në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich; megjithë problematikën e natyrës së kurrikulës së ofruar, eksperiencë e mbledhur me Universitetin e Greenwich është e vlefshme për të adresuar zhvillimin e një programi cilësor në fushën e arsimit të lartë.
2. Institucioni ka prioritet dhe tërheq në personelin e programit Master Shkencor në Drejtësi personel akademik të brendshëm e të jashtëm me edukim dhe eksperiencë të spikatur në fushën e drejtësisë dhe asaj akademike, përfshirë dhe personel të edukuar jashtë vendit dhe personel akademik të huaj. Qëndrimi i Institucionit ndaj kërkesave dhe verëjtjeve është përgjithësisht i hapur, mirëkuptues dhe bashkëpunues.
3. Me ndryshimin e subjektit pronar, Institucioni ka një administrim të ri; është e pritshme që administrimi i ri të jetë i nxitur dhe i prirur për procese përmirësuese e zhvilluese të programeve të ofruara.
4. Institucioni ka hapësira të bollshme, infrastrukturë të përshtatshme e të zhvilluar, auditore e salla laboratorike të bollshme, duke siguruar procese edukuese cilësore.

b. Pika të dobëta:

1. Programi ka tipare që mund të influencojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë jo ezauruese. Dedikimi i 60 krediteve nga 300 kredite të programit jo në lëndë të fushës së drejtësisë është i papërshtatshëm dhe nuk i qëndron as klasifikimit të lëndëve në kategori dhe përqindje sipas akteve nënligjore. Kjo duket edhe në mungesën në program të lëndëve klasike të programeve të drejtësisë si kriminalogji/penalogji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj.
2. Arritja e objektivave të programit vështirësohet edhe nga elementi i gjuhës së huaj që karakterizon programin. Për shkak të lidhjes së programit me burimet në gjuhë angleze, mbështetja në literaturë juridike në gjuhë anglisht sidomos për lëndët bazë të edukimit ligjor si e drejta civile, e drejta penale, e drejta administrative, lëndët procedurale etj. është dhe do të jetë e munguar për shkak të mungesës së botimeve të teksteve universitare mbi të drejtën shqiptare në gjuhën angleze.
3. Vështirësia në tërheqjen e personelit akademik vendas me grada e tituj dhe zotërues i mirë i gjuhës angleze është faktor pengues për arritjen e kërkesave ligjore në lidhje me angazhimin e personelit akademik me gradën shkencore “Doktor” e sipër duke bërë që në program të përfshihet edhe personel akademik që nuk zotëron grada e tituj sipas kërkesave ligjore për personelin akademik të programit të integruar Master Shkencor. Në vitin e fundit akademik janë bërë përpjekje për të rritur numrin e personelit të brendshëm në program më 2 anëtarë me tituj,



sidoqoftë programi vazhdon të mbështetet në një numër të ulët të stafit efektiv me ngarkesë të lartë me angazhim deri 9 lëndë brenda programit, duke vështirësuar edhe profilizimin e personelit në një drejtim.


4. Kreditet e programit zërthehen në mënyrë të papërshtatshme duke bërë që lëndë themelore të përgatitjes parësore të studentit të realizohen gjithsej në 39 orë leksione, duke vënë në dyshim gjerësinë dhe thellësinë e shqyrtimit të çështjeve në shtrirjen e nevojshme për përgatitjen e studentëve nga një program i integruar në drejtësi. Mospërfshirja e elementëve të tjerë të mësimdhënies përveç orëve të leksionit, nuk duhet të ndikojë në uljen e ngarkesës sado e dëshirueshme të jetë rritja e orëve të studimit të lirë nga ana e studentëve.
5. Nga ana e organizimit formal, programi ka mangësi mosevidencën formale të mënyrës si angazhohen strukturat e njësive në vendimmarrjet mësimore dhe shkencore. Në përgjithësi aktet e programit nuk kanë veshje formale, të gjitha aktet janë dokumenta *print* të thjeshtë, pa referenca në vendime strukturash, etj.
6. Për disa lëndë të programit në fjalë, literatura e detyrueshme nuk ofrohet në bibliotekën e Institucionit. Nevojitet përditësim i fondit të bibliotekës me tituj që pasqyrojnë zhvillimet më të fundit të debatit akademik.
7. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë funksionon si njësi e përhershme e ngarkuar me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Megjithatë nuk ka evidencë për një plan pune të Komisionit dhe as evidencë të raporteve vjetore qoftë të Komisionit, qoftë të Departamentit për vitet e mëparshme akademike, me përjashtim të vitit akademik 2017-2018. Raporti është përgjithësisht përshkruar.
8. Syllabuset e lëndëve në disa raste nuk respektojnë një format si dhe nuk japin informacion të detajuar lidhur me çështjet themelore dhe literaturën përkatëse. Në disa raste është evidencuar mbivendosje e temave si dhe mungesë koherence e brendshme.

c. Mundësitë:

1. Administrimi i ri përfaqëson një mundësi për nxitje të ndryshimeve në drejtim të përmirësimeve në institucion dhe në lidhje me programin e studimit në fjalë.
2. Hapësirat e Institucionit janë të përshtatshme dhe të favorshme për të zhvilluar programin në drejtim edhe të adresimit të kërkesave për përmirësimin e tij.
3. Mundësi aplikimi për grante kërkimore/mobilite sidomos në kuadër të projekteve e programeve të financuara nga Komisioni Evropian.
4. Me hartimin e dokumentit "Shtyllat Kryesore të Kërkimit për Qendrat dhe Departamentet në IAL (2018-2022)" ekziston mundësia për krijimin e sinergjive në rang Fakulteti për përmirësimin e kërkimit shkencor dhe publikimeve nga stafi i programit master.
5. Elementi i gjuhës së huaj rrit mundësitë për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar si dhe mobilitetin në të dyja drejtimet.

d. Pengesat:

1. Elementi i gjuhës së huaj është sa mundësi e mirë aq edhe pengesë në drejtim të tërheqjes së personelit akademik në linjë me kërkesat ligjore për grada e tituj e sidomos në drejtim të literaturës juridike që duhet të mbështetë një program drejtësie që vendos bazat themelore të përgatitjes së profesionistëve shqiptarë të drejtësisë.



Rekomandime:

1. Rekomandohet që Institucioni të rishikojë pjesët e programit dedikuar lëndëve që nuk lidhen me fushën e së drejtës.
2. Rekomandohet që Institucioni të reflektojë lidhur me mësimdhënien në gjuhën angleze, e cila përbën një avantazh në krahasim me programet e tjera, por në të njëjtën kohë shkakton vështirësi duke qenë se pjesa më e madhe e programit akademik është e lidhur me edukimin në të drejtën shqiptare.
3. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa për plotësimin e kërkesave ligjore dhe të verë në dispozicion të programit staf akademik minimalisht me gradën shkencore "Doktor" e sipër, duke mbajtur parasysh dhe limitet për përfshirjen e stafit efektiv në disa lëndë njëkohësisht brenda programit.
4. Rekomandohet që Institucioni të garantojë ngarkesën e nevojshme për çdo lëndë me qëllim shqyrtimin e çështjeve me gjerësinë dhe thellësinë e nevojshme për një program të integruar në drejtësi.
5. Rekomandohet që Institucioni të përmirësojë anën formale të vendimmarrjes me përmirësimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e procedurave formale dhe evidencave përkatëse.
6. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa të vazhdueshme për përditësimin e literaturës në bibliotekë si dhe të sigurojë literaturën e nevojshme për lëndët e detyrueshme.
7. Rekomandohet që Komisioni për Sigurimin e Cilësisë të hartojë një plan veprimi si dhe të hartojë raporte për të gjitha kontrollet që ndërmer duke përfshirë gjetje konkrete të cilat pasohen nga masa me qëllim sigurimin e cilësisë.
8. Rekomandohet që syllabuset e evidentuara si problematike në raport të rishikohen në mënyrë që të respektohet një format, studentët të marrin informacion të detajuar lidhur me çështjet themelore dhe literaturën përkatëse, të evitohen mbivendosjet, si dhe të sigurohet një koherencë e brendshme.
9. Rekomandohet që administrimi i ri të marrë parasysh gjetjet e këtij raporti dhe të marrë masa për përmirësimin e programit të studimit në fjalë.
10. Rekomandohet që Institucioni të përdorë hapësirat dhe infrastrukturën që ka në dispozicion me qëllim përmirësimin e programit të studimit.
11. Rekomandohet që Institucioni të shtojë aplikimet për grantet kërkimore dhe të mobilitetit me qëllim përmirësimin e programit në fjalë.
12. Rekomandohet që stafi akademik i programit të studimit në fjalë të përfshihet më shumë në kërkim shkencor si nga pikëpamja sasiore por dhe cilësore me qëllim përmirësimin e kërkimit shkencor në funksion të programit të studimit.
13. Rekomandohet që Institucioni të reflektojë lidhur me mundësitë dhe pengesat që lidhen me zhvillimin e programit në gjuhën angleze dhe të marrë masat përkatëse.

III. SUMMARY OF THE ANALYSIS ON THE ASSESSMENT OF THE STUDY PROGRAMME


a. Strengths:

1. For some academic years, the study programme has been performed in cooperation with the University of Greenwich; despite some problems concerning the curricula, this experience with the University of Greenwich is a valuable one in order to develop a quality programme in higher education.

2. One of the priorities of the institution is to attract internal and external academic staff with valuable experience in practice and academia, including staff who have completed their education abroad or foreign academics. The institution has an open and cooperative approach towards requests and remarks.
3. With the change of ownership, the institution has a new management: it is to be expected that the new management will have incentives to improve and develop the existing study programmes.
4. The institution has sufficient space, adequate infrastructure, halls and seminar rooms that make it possible to offer quality study programmes.

b. Weaknesses:

1. Some features of the programme may influence the preparation of students in a non-exhaustive way. Devoting 60 EC from 300 EC to subjects that do fall within the area of law is not appropriate and does not comply with the division of subjects in categories and percentages as determined in law. This emerges also in the lack of subjects such as criminology, criminalistics, legal medicine etc.
2. Teaching in a foreign language (English) renders difficult the fulfillment of the learning objectives. The study programme under review relies on English sources; however, this is difficult for basic subjects such as civil law, criminal law, administrative law, other procedural subjects given the fact that there is a lack of legal texts on Albanian law in English.
3. Difficulties in attracting local academic staff with academic degrees and titles and who are fluent in English represent an obstacle in complying with the law requirements according to which academic staff with at least a doctoral degree should be involved in a master programme. As a result, academic staff without a doctoral degree have been involved in teaching in the study programme. In the last academic year, there have been efforts to increase this number by hiring two such staff, however the study programme is based on a low number of full time academic staff who are then involved in many subjects at the same time, making difficult the creating of academic profiles.
4. Credits are not reflected in an appropriate manner; important subjects of the programme are dealt with in 39 hours of lectures. This raises doubts on the depth and breadth of each subject. The fact that other elements of teaching are not included, should not cause a reduction in work load for each subject despite the desirability for independent work by students.
5. From the perspective of formalities, the programme lacks evidence on how different levels and units are involved in the decision making of academic and scientific activities, etc. In general, the acts produced by the institution do not have the required formal elements, all documents reviewed are simply prints, with no reference to formal decision making.
6. In some subjects, mandatory reading materials are not to be found in the library. Existing literature in the library must be updated in order to reflect the latest academic debate.
7. The Quality Assurance Committee functions as a permanent structure in charge of ensuring the quality. However, there is neither evidence of an action plan by the Commission, nor of annual reports with the exception of the those for the academic year 2017-2018. Yet, the report is generally descriptive.
8. Syllabi of some subjects do not follow a certain format and do not give detailed information on basic issues and respective literature. In some cases, there has been an overlap of themes and lack of internal coherence in these syllabi.



c. Opportunities:

1. The new management represents an opportunity towards improvements in the institution and with regards to the study programme.
2. The institution offers ample space and infrastructure for the development of the study programme and for addressing suggestions aiming at improvement of the study programme.
3. Opportunities for grant applications/mobility grants, including those supported by the European Commission.
4. With the adoption of the document "Main Pillars of Research for Scientific Centres and Departments (2018-2022)", there is an opportunity for the creation of synergies at the Faculty level for improving scientific research and publications by academic staff.
5. Teaching in foreign language increases opportunities for regional and international cooperation and mutual mobility.

d. Obstacles:

1. Teaching in a foreign language represents an opportunity but also an obstacle especially with regards to hiring academic staff who complies with the legal requirements and especially with regards to literature that is supposed to support such a programme and lay the foundations for such education in law.

Recommendations:

1. It is recommended that the institution revises parts of the programme dedicated to subjects that are not related to law.
2. It is recommended that the institution reflects on having English as the teaching language. It represents an advantage compared to other programmes but at the same time it seems to create difficulties given the fact that most part of the academic programme is related to teaching of Albanian law.
3. It is recommended that the institution adopts measures for the fulfillment of legal requirements by including academic staff who at least have the academic degree of "Doctor" and by respecting the limits for the involvement of full-time staff in many subjects at the same time.
4. It is recommended that the institution guarantees the necessary workload for each subject so that issues are dealt with the necessary breadth and depth in such an integrated programme in law.
5. It is recommended that the institution takes measures that would improve the formal aspect of decision making based on formal procedures and supporting documentation.
6. It is recommended that the institution ensures that the library includes updated texts and materials and that it contains all mandatory literature.
7. It is recommended that the Quality Assurance Committee drafts an action plan and submits reports for all review activities that it performs including concrete findings and follow-up measures.
8. It is recommended that those syllabi that are identified as problematic in this report are revised with a view of complying with the format and with providing detailed information to students with regards to basic issues and literature. Furthermore, syllabi should avoid overlap and should ensure internal coherence.

9. It is recommended that the new management considers the findings in this report and takes measures to improve the study programme under review here.
10. It is recommended that the institution uses the space and infrastructure at its disposal with a view of improving the study programme.
11. It is recommended that the Institution increases the number of research and mobility grant applications with a view to improving the quality of the study programme.
12. It is recommended that academic staff of the study programme gets involved more in academic research both from a quantitative and qualitative perspective , with a view to improving the scientific research profile of the study programme.
13. It is recommended that the institution reflects and takes the appropriate measures with regards to teaching in English; it is an opportunity but at the same time a potential obstacle as discussed in this report.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Evis Alimehmeti



2. Dr. Darinka Piqani

